

# GËTE

# POEZI

J. V. GËTF

# POEZI

Përkthyer nga
LASGUSH PORADECI

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1962

Redaktor: Luan Rexhepi
Korektore letrare: Adelina Mamaqi
Piktor: Hysen Devolli
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi 2000 kopje Format 78X109/32 Stash: 2204-55

Shtyp. N.I.SH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë

## VJERSHAT E GËTES

*Në krijimtarinë e gjërë të Gëtes vjershat lirike zënë një vend kryesor. Poeti i madh gjerman filloi të vjershërojë që i vogël. Që në rininë e tij të parë duket pulsi poetik dhe personaliteti i tij i qartë. Dhe vazhdoi të krijojë vjersha deri në pleqërinë më të shtyrë krahas gjinive të tjera më të gjëra.*

*Qoftë nga pikëpamja e brendisë, qoftë nga ajo e formës, lirikat e Gëtes janë ndër krijimet e tij më të përsosura. Ai shkroi poezi në çdo çast: në çaste dashurie, gëzimi ose hidhërimi, në çaste hovesh shpirtërore nga më të ndryshmet.*

*Poezia e tij buroi gjithnjë nga çaste të jetuara. Subjektet e lirikave të Gëtes janë shumë të pasura. Ndjenja dhe mendimi i tij përqëndrohen në çfaqje të ndryshme të jetës, në objektet më të ndryshme dhe ai gjen anën poetike kudo; aspektet e jetës ai ja komunikon lexuesit nepër filtrin e ndjenjave të tija, poezisë së tij të fuqishme. Ja se si i është rrëfyer një mikut të tij shumë të afërm, Ekermanit: «Kaqë e madhe dhe e pasur është bota, kaqë gjëra ka jeta, sa kurrë nuk mungojnë subjektet për poezi. Por motivi dhe lënda e poezisë duhet të nisen nga realiteti. Një rast i veçantë bëhet i përgjithshëm e poetik pikërisht kur e merr në dorë poeti. Të gjitha vjershat e mia janë të nisura nga raste të caktuara: realiteti është ai që i ka frymëzuar, aty e kanë bazën, aty marrin ushqim. Nuk kam krijuar kurrë poezi në erë. As që mund ta dëgjoj mendimin se realitetit i mungon interesi poetik. Aftësia e poetit tregohet pikërisht këtu: të kapi anën interesante, poetike edhe tek subjektet më të zakonshme. Realiteti jep lëndën, motivin, pikënisjen, por të krijosh*

nga këto të dhëna diçka të gjallë..: ja vepra e poetit». Sipas Gëtes poeti duhet të çfaqi tërë veten e tij dhe njëkohësisht të jetë i aftë të ndjejë brengën dhe gëzimin e çdo njeriu.

Në këto fjalë të Gëtes shohim se shprehen normat që kanë udhëhequr shkrimtarët e mëdhej realistë të të gjitha kohëve. Lidhja e ngushtë e poezisë me realitetin: ja vija kryesore nëpër të cilën ecën rruga krijuese gjatë gjithë veprimtarisë së Gëtes.

Tek Gëteja shkrihej në një të tërë të pandarë njeriu dhe poeti. Ja ç'thotë Turgenjevi mbi Gëten: «Ai ishte një cope: jeta dhe poezia nuk ndaheshin tek ai si dy botë në vete: Jeta e tij është poezia e tij, poezia e tij është jeta e tij».

Lidhja me jetën, me shpirtin e kohës, përbën esencën kryesore të poezisë së Gëtes. Bjelinski, duke folur për Gëten thotë në një vend: «.. Prometheu i tij shpreh frymën mbizotëronjëse të epokës..:»

Lirikat e Gëtes nuk janë diçka e radhës së dytë në veprën e tij të madhe. Përkundrazi janë, siç thamë më lart, krijime të përsosura, gjeniale, që nuk qëndrojnë aspak nën veprat e tij të mëdha poetike, si «Fausti» etj. Për më tepër lirikat e tij kanë një lidhje të brendëshme të vazhdueshme me krijimet e tij më të gjera: ato, sipas çastit që janë shkruar, shprehin po ato hove shpirtërore, po atë entusiazëm, po ato ide që pasqyrohen edhe në veprat madhore (t'i quajmë kështu duke pasur parasysh gjerësinë e tyre). Në mes tyre ka pastaj edhe lidhje të tjera: lirika të fuqishme gjejmë si hyrje veprash, në mes të akteve të dramave ose kapitujve të romaneve (si Kushtimi i «Faustit». «Mbreti i Tules», «Mignon», etj).

Gjatë veprimtarisë letrare Gëteja shkroi lirika nga më të ndryshmet: Këngë (Lieder), hymne, ode, ballada, elegji, epigrame, etj.

Ndër vjershat e Gëtes shquhen lirikat e fuqishme të periudhës «titanike». Jemi në kohën e lëvizjes «Sturm und Drang» (Stuhi e vrull). Rinia përparimtare gjermane që nuk duronte dot zgjedhën shoqërore e shpirtërore të sistemit feudal, është rebeluar, duke u bërë kështu



shprehje e protestës së borgjezisë gjermane kundër renditë në fuqi. Rebelimi i rinisë përparimtare gjermane që i kufizuar, i palidhur me ndonjë lëvizje revolucionare që borgjezia gjermane e kohës ende nuk ishte në gjendje ta fillonte. Por nga gjiri i asaj rinie, në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, dolën poetë e shkrimtarë të vrullshëm që shpallën me zjarr idealin e lirisë, idealin e çlirimit të personalitetit njerëzor nga çdo shtypje e kufizim. Veprat e kësaj periudhe në letërsinë gjermane karakterizohen nga një pathos i zjarrtë liridashës, nga një vrull i papërmbajtur idesh. Në radhën e këtyre shkrimtarëvet shquhet edhe Gëteja i ri. Të kësaj kohe janë monologët e parë të «Faustit» me të cilat shprehet angthi, tensioni i mendimeve dhe i ndjenjave i të gjithë një brezi njerëzish, shprehet kërkesa e zjarrtë për të gjetur një rrugëdalje filozofike - shpirtërore nga ajo gjendje e padurueshme. Po në këtë kohë Gëteja skicon planet e krijimit të disa dramave që mbetën të pambaruara. Nga puna preqatitore për këto drama mbeti ndonjë lirikë e fuqishme si «Kënga e Muhametit», «Prometheu», etj. Në të parën shprehet në mënyrë figurative lindja e një ideje në formën e një burimi që shpërthen diku mes shkrepash, që rritet, bëhet përrua, lumë i madh, e më së fundi, duke marrë me vete shumë përrenj e lumej të tjerë më të vegjël, derdhet në detin e gjerë. Ndjejmë shumë qartë nepërmjet simbolikës së figurave gjendjen shpirtërore të poetit dhe të brezit të tij, të etshëm për t'u gjetur një zgjidhje pyetjeve të tyre, për të gjetur «të vërtetën e madhe».

Me figurën e Prometheut shpërthen me fuqi rebelimi, urrejtja kundër shtypjes, vetëbesimi në forcat njerëzore për luftë të papajtueshme kundër tiranisë.

*Unë nuk di gjë më të mjeruar*
*Nënë diell, përveç, jush, o zotër!*
. . . . . .
*Dhe do të vdisnit urije*
*Sikur mos kish të lutur dhe lypës*
*Budallenj plot me shpresë.*

. . . . . .

*Unë të të falnderoj ty? Përse?*
*Ke lehtësuar ti ndonjëherë dhëmbjet*
*E të shumë-rënduarit?*
*Ke tharë ti ndonjëherë lotët*
*E të angthmunduarit?*

*Me fjalë të këtilla u drejtohet Prometheu perëndive, Zeusit, që në mënyrë të qartë simbolizojnë tiranët. Dhe pastaj, i ndërgjegjshëm për misionin e tij, si një titan i revoltuar që do të përhapi në zemrat e njerëzve idetë e tija të rebeluara dhe do të ndikojë në ndërgjegjet e tyre, flet:*

*Këtu rri unë, krijoj njerëz*
*Pas fytyrës sime,*
*Një brez që t'jet' i njejt me mua*
*Të vuaj, të qajë,*
*Të shijojë dhe të gëzohet,*
*Dhe ty mos të ta varri veshin, si unë!*
*Si unë!*

*Siç shihet, mitin e Prometheut, Gëteja e veshi me sukses me petkun e ideve të kohës së tij. Sado që në autobiografinë «Poezia dhe e vërteta» poeti përpiqet ta shikojë në mënyrë më «objektive» figurën e Prometeut, kjo mbetet gjithnjë, ashtu siç na paraqitet te lirika e vitit 1774, një shprehje e zjarrtë e luftës kundër tiranisë që kish çuar peshë zemrat e të rijve përparimtarë të kohës.*

*Të këtij grupi e të kësaj periudhe janë edhe disa lirika të tjera si «Kufi të njerëzimit», «Ganimedi» «Karrocierit Kronos», «Këngë shtërgate e udhëtarit», etj. Karakteristikë e përbashkët e këtyre hymneve është vrulli i ideve, hovi i ndjenjave, lidhja e thellë dhe e gjallë e poetit me jetën, dashuria dhe adhurimi i pakufi për natyrën. Këto ndjenja e pasione të vrullshme, poeti nuk i ka mbërthyer në vargjet e në rimat tradicionale. Vargu shpërthen i lirë, me hove pindarike shprehjesh, pa rimë. Ndonëse në letërsinë gjermane të kohës*



*vargjet e lira nuk ishin diçka e re, (i kish përdorur p.sh. edhe Klopshtoku), kjo formë e re rrodhi si një nevojë e brendëshme e poetit. Por nuk u bë «manierë» tek ai. Ai u kthye përsëri tek vargjet tradicionale. Më vonë, edhe kur shkruan poezi plot trazim pasionesh (p.sh. «Elegjia e Marienbadit») ai përdor vargje dhe strofa të rregullta.*

* * *

*Një kapitull i rëndësishëm në lirikën e Gëtes janë Këngët (të njohura në letërsinë botërore me emrin gjermanisht Lieder). Gëteja është një poet spontan, komunikues. Krijon në mënyrë të vetvetishme, të thjeshtë. Ndjenja ose mendimi më i thellë pasqyrohen me një shprehje dhe një gjuhë shumë të qartë. Për këto cilësi ushtroi një ndikim të mirë tek poeti edhe poezia popullore. Që kur studionte në Shtrasburg, poeti i njohur gjerman Herder i futi në zemër dashurinë për poezinë popullore. (Herderi është një ndër studiuesit e parë të folklorit në letërsinë evropiane, bile në këtë drejtim u bë si një paraardhës i romantikëve të cilët, në kundërshtim me përkrahësit e klasiçizmit, kishin një adhurim të veçantë për poezinë popullore). Gëteja përvetësoi anët më pozitive të poezisë popullore, thjeshtësinë, sinqeritetin e shprehjes së ndjenjave, formën e qartë, por nuk u bë kurrë një imitues i ngurtë i saj. Te Këngët ai niset gjithmonë nga një përshtypje, nga një emocion «i tij». Kështu vjersha, së bashku me natyrshmërinë e thjeshtësinë e poezisë popullore, ka edhe vulën e personalitetit të tij poetik, ka origjinalitet.*

*Burim tjetër për Këngët e Gëtes është poezia erotike e shekullit XVIII, me tonin e saj galant e gazmor. Ai u ndikua prej kësaj poezie vetëm përsa i përket disa karakteristikave të formës e të tonit, por duke hedhur poshtë gjithë konvencionalizmin dhe artificialitetin e saj. Përsëri personaliteti i tij e kapërxeu edhe këtë ndikim. Ishte realiteti ai që mbizotëronte te poeti në çastet e frymëzimit, jeta dhe njerëzit rreth tij, ndjenjat e tij të gjalla të jetuara dhe jo të imagjinuara.*

Këngët e para Gëteja i ka shkruar që në moshën më të re. Që në këto vargje të para, ndonëse nën ndikimin e modës poetike të kohës, ndjejmë gjallërinë krijonjëse të një poeti të madh. Motivi kryesor është dashuria. Dhe jo një dashuri abstrakte, një dëshirë për dashuri, por një ndenjë reale për këtë ose atë vajzë, me të cilën poeti në të vërtetë njihej ose kishte marrëdhënie. (si Ana Shënkopf, Frederika Brion, etj). Nga poezitë e lehta me frymë gazmore që i drejton Anetës, kalon në këngët plot ndjenjë e delikatesë për Frederikën nga e cila e ndau rrjedha e rrëmbyeshme e jetës së tij, ecja e papërmbajtur e temperamentit të tij drejt kërkimesh e zbulimesh të reja. Pastaj, pas këngëve të para të rinisë vijnë poezitë e dashurisë së një moshe më të pjekur, ku pasqyrohen çaste të tjera të jetës së tij, poezi kushtuar vajzave ose grave që deshi e adhuroi. (Lili Shëneman, Karlota Buf, Lida fon Shtain, Kristiana Vulpius, etj. deri te pasioni i fundit për Ulrika fon Levecofin). Lirika e tij në këto vjersha nuk qe gjithnjë aqë e gëzueshme, shpesh gjejmë aty thirrje të dhëmbëshme pasioni, arësyetime serioze, shpesh «analizon» dashurinë e tij, por gjithmonë, në çdo vjershë gjejmë sinqeritet poetik dhe mjeshtri artistike. Me një realizëm të thellë dhe me një gamë të pafund ngjyrash e zërash, ai pasqyron ndër vargje shpirtin e tij, shpirtin njerëzor, pse lirika e tij nuk kufizohet kurrë tek një «unë» i shkëputur nga njerëzit, por shpreh gjëndje shpirtërore që i ndjen dhe i vuan çdo njeri. Gëteja, i lirë nga paragjykimet, këndon me sinqeritet për gjithë atë që ndjen, deri në moshën më të plakur. Ai është «poeti» për antonomazi, dhe, ndonëse kish arritur në kulmet më të larta të filozofisë e të shkencës, ndonëse qe një ndër personalitetet më të ndritura të mendimit, bintë shpesh në situata «naive», e ndjente veten ende të ri në shpirt dhe, larg nga çdo frikë skandali e pështpëritjesh, e linte veten të lirë në marrëdhëniet e tija dhe shprehte haptas atë që ndjente në shpirt.

Dashuria për Gëten ishte një ndjenjë zakonisht e gëzueshme që e nxiste për punë, që e frymëzonte për krijime. Edhe atëhere kur ndjente mundim e brengë në zemër, kur lëkundej në mes një lumturie të madhe dhe një dëshpërimi të pafund, edhe atëhere e quante veten të lumtur. Në një letër i thotë Zonjës fon Shtain: «Jo, dashurinë që kam për ty, nuk mund ta quaj «pasion»; ajo është bërë si një sëmundje, por një sëmundje që e dua më shumë se shëndetin më të mirë, një sëmundje nga e cila nuk dua të shërohem.. »

Në poezinë e dashurisë pasqyron humore të ndryshme. Ai shpesh këndon plot gëzim e gjallëri. Ja tri strofa nga një këngë e vitit 1774, «Kristja» (një Kristinë tjetër, jo Vulpiusi):

Kaq herë zhytem në mendime
Dhe gjaku më rëndon!
Po kur jam pranë Kristës sime
Ç'do gjë zë më këndon.
. . . . . .

Syzezë krejt e lozonjare
Dhe vetullzezë krejt,
Më çelet zemra vetmitare
Kur ja shtje sytë drejt.
. . . . . .

Ku skuq kjo gojë siç ma kënda
Dhe faqk' e rrumbull plot?
Ah, dhe diçka ësht' e rrumbull brënda
Nuk ngopet syri dot!

Këngët erotike të Gëtes kanë secila diçka të vetën, por të gjitha kanë të aartë e të dallueshme atë që mund ta quajmë «stili» i Gëtes. Ato pasqyrojnë çaste të vërteta, të jetuara, njerëzore, që na e bëjnë më të kuptueshëm poetin si njeri.

* * *

Shumë të njohura në letërsinë botërore janë balladat e Gëtes. Këto nuk i përkasin një periudhe të caktuar të veprimtarisë së tij. Gëteja shkroi ballada që në rininë e parë e deri në fund të jetës së tij. Ndonëse nuk janë shumë në numër (rreth tridhjetë), ato janë ndër krijimet më

të mira të poetit. Balladat e para i shkroi në atë kohë kur me entusiazëm gjeti atë që kërkonte te poezia popullore. Dhe balladat, legjendat popullore ishin ndër krijimet më të bukura që populli, duke i sjellë gojë në gojë gjatë shekujve, i kish lëmuar dhe i kish bërë gjithnjë më të përsosura. Dëshirat, mendimet dhe ëndrat e popullit që pasqyrohen në këto ballada me forcë të madhe poetike dhe me figura tërheqëse e origjinale, e magjepsën Gëten. Ai gjeti tek ato një formë poetike shumë të përshtatëshme për të shprehur botën e tij. Mori nga poezia popullore vargun karakteristik të balladës, atë ton tërheqës, ato figura përrallore e poetike që e ndihmuan për të thënë atë që donte. Por ai diti të ruajë masën, diti të ruajë origjinalitetin e tij. Dihet se romantikët pasivë morën nga balladat, të misterëshmen», të tmerëshmen» dhe e theksuan atë në një mënyrë të sëmurë. Ata, nëpërmjet të balladave që u bënë të modës në kohën e tyre, thelloheshin gjithnjë më shumë në mistikë. Ndërsa Gëteja, si poet me shpirt e me mendime të shëndosha, shfrytëzoi gjininë e balladës për të dhënë gjëndje të ndryshme shpirtërore, ide të shumta, me forma e me tone nga më të ndryshmet, pa kërkuar kurrë me artificialitet efekte ngjethëse. Balladat e Gëtes kanë gjithmonë diçka njerëzore në thellësinë e tyre, edhe ato që duken më «të frikëshme» ose «të misterëshme». Te «Peshkatari» p.sh. ndonëse një gërshetëz e josh dhe e përpin n'ujë peshkatarin e ri, ne dallojmë qartë simbolikën, domethënien njerëzore. Ose tek «E fejuara nga Korinti» ne ndjejmë menjëherë, nëpërmjet figurës fantastike të vajzës që çohet nga varri, një problem të thellë psikologjik, moral e shoqëror. Kështu mund të përmëndim çdo balladë të Gëtes ku çfaqet elementi i mistershëm e fantastik, aqë i shfrytëzuar me vënd e pa vend, në fillimin e shekullit XIX. Gëteja edhe nepërmjet këtyre elementeve fantastike mbetet gjithnjë poet «i tokës», i lidhur me logjikën e shëndoshë të njeriut të zakonshëm. Fantastikja, e misterëshmja nuk ja humbin ekuilibrin shpirtëror: ai i trajton ato në mënyrë të qetë, objektive. Shpesh subjekti i balladës trajtohet si me shaka, në mënyrë të qeshur e gazmore. Ky ton gazmor dhe buzëqeshja ironike nuk ndahen thuajse asnjëherë nga balladat e tija. Kështu atmosfera e rëndë tek e cila mund ta çonte subjekti, davaritet nga toni skercoz i tregimit, i dialogut. Poeti vazhdon tregimin herë me seriozitet herë në formë shakaje. Ky ton tregimi që jepet me një elegancë poetike të pashoqe, krijon një atmosferë më njerëzore, më të gëzueshme, më «inteligjente».



Nuk janë të rralla motivet shoqërore në balladat e Gëtes. Psh. te ballada «Para gjyqit» një vajzë që ka lindur një fëmijë jashtë ligjit, mbron para gjyqit pastërtinë e dashurisë së saj, duke vënë përballë ligjit dhe dënimit të njerëzve, ligjin e madh të natyrës. Tek «Nata e parë e Valpurgës» paraqitet me forcë dramatike lufta e vendosur e druidëve për idealin e tyre. Po kështu problemet të rëndësishme shoqërore e morale ngrihen tek «E fejuara nga Korinti» «Pariat», Në poezitë: «Perëndia dhe bajadera».

* * *

Në shtatorin e vitit 1786 Gëteja u nis për një udhëtim në Itali. Jeta në Vajmar i ish rënduar. Ambjenti i ngurtë, punët shtetërore e administrative e kishin lodhur e mërzitur. Shpirti i etur poetik kishte nevojë për një largim. Me 29 tetor të atij viti arriti në Romë. Roma, Italia i dhanë çaste lumturie dhe ekuilibri. Në këtë atmosferë lindën «Elegjitë romane», një faqe tjetër e njohur e lirikës së Gëtes. Ai u ndikua qoftë nga arti klasik që ka lënë akoma gjurmët e tija në kryeqytetin e vjetër të perandorisë romake, qoftë nga leximi i letërsisë klasike latine, sidomos i poetëve lirikë Katuli, Tibuli, Properci, etj. Në «Elegjitë romane» ka përdorur me shkathtësi të madhe hekzametrin klasik. Në to pasqyrohet gjëndja e qetë shpirtërore e poetit, kënaqësia fizike e dashurisë, nepërmjet të së cilës e sheh botën gëzueshëm e pa derte. Ndikimi i poezisë erotike latine është i qartë. Kjo periudhë në veprimtarinë letrare të Gëtes që ndikoi në atë që quhet «klasiçizmi i Vajmarit», është tranzitore.

*Në vitin 1814 Gëteja lexoi poezitë e poetit persian Hafizit, në përkthimin gjermanisht të fon Hamerit. Në 1815 shkroi mbi këto poezi: «Më përpara, nga përkthimet e veçuara të këtij poeti të madh, të shpërndara aty këtu në revista të ndryshme, nuk nxora ndonjë gjë të madhe. Tani që më dolën përpara të gjitha së bashku, ato më bënë shumë përshtypje... Gjithë ajo që ndjeja në shpirt dhe që i ngjiste si ndjenjë e si ide asaj që kisha parasysh, u zgjua...» Gëteja e ndjeu veten edhe një herë të ri. Njëra pas tjetrës krijon lirika të reja të cilat i përmbledh në vëllimin e njohur «Divani oksidental-orientalˮ i cili filloi të botohet në 1817. Divanin vazhdoi ta zgjerojë deri nga viti 1820. Pastaj, i zhytur në punë të tjera, e harroi. Një mbrëmje të janarit 1827, në shtëpinë e Gëtes u këndunan disa romanca nga «Divani», të vëna në muzikë nga kompozitori Ebervain. Kur mbaroi mbrëmja, Gëteja i tha Ekermanit: «Sonte munda të vrej se këto këngët e Divanit nuk gjejnë më asnjë jehonë brenda meje. Ajo fryma orientale dhe e apasionuar më është shuar në shpirt. Ka rënë si një lëkurë gjarpëri dhe ka ngelur në mes të rrugës. Ç'është e vërteta, më ndodh shpesh që gjërat e mia më duken krejt të huaja....»*

* * *

*Gëteja është shumë i njohur në letërsinë gjermane edhe për epigramet e tij. Nga më të rëndësishmet janë ato që shkroi e botoi së bashku me Shilerin: «Kseniet» (Xenie-dhurata). Në qershorin e vitit 1794 Gëteja kish filluar të bashkëpunonte në revisten «Orët», themeluar nga Shileri, Fihteja, dhe Humboldti. Kjo revistë, në të cilën Gëteja botoi ndonjë vepër të vetën, nuk pati sukses dhe u përçmua nga gazetat letrare të kohës. Dy poetët reaguan me një sulm epigramesh të mprehta, Kseniet, modelin e të cilave Gëteja e mori nga poeti romak Marciali. U botuan në vjeshtën e vitit 1796 në «Almanakun e muzave» tjetër revistë e drejtuar nga Shileri. Me këto epigrame sulmoheshin grupe letrare, rryma, opinione edhe njerëz të veçantë. Shpesh njeri nga dy poetët jepte*



*idenë, tjetri shkruante vargjet. Nganjëherë njeri shkruante një ose dy vargje, tjetri plotësonte strofën. Në pakë kohë ata shkruan gjashtëqind Ksenie, të cilat bënë bujë të madhe. «Kseniet» shkruan më vonë Gëteja, «që në fillim qenë të lehta e që pastaj u bënë gjithnjë më thumbonjëse e më të ashpra, na morën disa muaj kohë. Ato shkaktuan shumë trazira në letërsinë gjermane. Nga një pjesë e publikut lexonjës u dëmtuan si një abuzim i madh i lirisë së shtypit».*

*Ekermani, pas një bisede me Gëten në vitin 1825, shënonte: «Në lidhje me Kseniet, Gëteja çmonte sidomos ato të Shilerit, të cilat i quante të mprehta dhe thumbonjëse, ndërsa të tijat i vlerësonte si më të buta e pa ndonjë rëndësi të madhe... Por ndikimi i Ksenieve në letërsinë gjermane të asaj periudhe qe shumë i madh e i dobishëm». Më vonë Gëteja botoi edhe një vëllim tjetër epigramesh titulluar «Kseniet e butaˮ. — Të njohura janë edhe «Epigramet veneciane» të quajtura kështu pse pjesën më të madhe të tyre e shkroi në Venedik, gjatë udhëtimit në Itali.*

*Në epigramet e Gëtes shkëlqen gjykimi inteligjent, arti i tij lakonik dhe gjallëria e ideve.*

* * *

*Seria e vjershave të Gëtes nuk mbaron edhe këtu. Shumë vjersha të tija nuk kategorizohen në asnjerin prej grupeve që u përmendën sipër. Të panumurta janë subjektet dhe gjinitë që trajtoi. Ai shkroi poezi filozofike me të cilat reagonte ndaj problemeve filozofike të kohës. Gëteja, qe një poet - filozof. Ai diti t'i shmanget anëve më absurde të filozofisë së kohës dhe ta lidhi mendimin abstrakt filozofik me jetën e gjallë. Dhe në këtë drejtim qe një shëmbull i shkëlqyeshëm.*

*Në mes të vjershave të tija gjejmë shpesh të tilla që mund t'i quash skena satirike; ka shkruar vjersha «shoqërieˮ, parabola letrare, etj. Të gjitha këto tregojnë jo vetëm aftësi të pafund letrare, por edhe se Gëteja si poet e si njeri qe i lidhur gjallërisht dhe në mënyrë të*

*shumanëshme me jetën. Dhe ja si i thotë, me modesti por me shumë kuptim, një miku, në vitin e fundit të jetës së tij: «Çfarë kam bërë unë? Unë kam mbledhur e kam shfrytëzuar atë që kam parë, që kam dëgjuar, që kam vrejtur. Veprat e mia kanë marrë ushqim nga mijëra njerëz të ndryshëm: injorantë dhe të ditur, inteligjentë dhe budallenj, fëmijë, të rritur, pleq të thinjur, gjithfarësh kanë ardhur e më kanë ofruar mendimet dhe aftësitë e tyre, shpresat e tyre, jetën e tyre. Shpesh unë kam korrur aty ku kanë mbjellë të tjerët. Vepra ime është fryt i një kolektivi dhe ka marrë emrin Gëte».*

PERTEF KRUJA



## KUSHTIM

Mëngjezi erdh; dhe hap' i tij i leht ë
Ma ngriti gjumin që më kish në gji,
Un' ika malit nga kasoll' e qetë,
Duke baritur me një shpirt të ri;
Ma mbushte zemrën me dëfrim e jetë
Lul' e vesuar plot me freskësi;
Një dritë hareje niste për t'u çfaqur,
Kënaqte botën për të më kënaqur.

Dhe si po ngjitja, që nga lumi i dlirë
Valonte larg një mjergull pa pushim.
Ajo më futi në një mugëtirë,
Ma vrënjti rreth për qark vështrimin tim:
S'do ta shijonja pamjen aq me hirë,
U mblodh kudo një muzg, një turbullim;
Pastaj prej resh u gjinda si i sulmuar,
Dhe vet' i vet në t'errët i mbuluar.

Menj'herë dielli u duk të depërtojë,
Në mjergull u ndërpa një qartësi.
Këtej zu muzgu tatëpjet' të shkojë;
Andej të ngjitet përmi pyll të zi.
Si më desh syri diellin ta vështrojë,
Pas errësirës, më me bukuri!
Luft' e tejdukshme s'kishte përfunduar,
Erdh një shkëlqim, dhe mbeta i verbëruar,

Po shtytj' e zemrës, që të shoh ç'do jetë,
Më bëri të dal prapë me kuxim
Ahere pashë, me një sy të shpejtë,
Se çdo gjë digjej tërë flakërim.

Më nqasej afër, duke e mbajtur retë,
Një femr' e perëndishme në vështrim.
Nuk kisha parë aq bukuri ndonj' herë;
M'i shtinte sytë dhe valonte n'erë,

S'më njeh ti vallë? foli gojëlehtë,
Me zemr' e dashuri në kuvëndim;
S'më njeh ti mua, që, balsam të fortë
T'i shtira plagës sate për shërim?
Oh, ti më njeh, se lidhje përgjithjetë
Me mua pate dashur pa pushim.
S'të pashë aq shpesh, me mall e vaj e lotë,
Si djaloshar të më kërkosh në botë?

Po! brita unë, dhe m'u ndrit fytyra
Dh'u shemba poshtë, fort po të kërkoj;
Ti më dhe paqen, kur nëpër gjymtyra
Rini' e zjarrshme thellë më përshkoj;
Dhe qiellorisht me mijëra mënyra
Magjia jote ballin ma freskoj,
Ti më ke falur kaq dhurata hareje,
Dhe çdo gëzim, që sot, e pres prej teje!

Nuk ta them emrin. Shumëkush mi tokë
Ta thotë shpesh, të quan si të tij,
Sikush për shënjë ty të ka në kokë,
Po drita jote i sjell vështirësi.
Ah, kur gabonja, kisha shumë shokë,
Sot që të njoh, jetoj në vetësi;
Se lumtërinë e ndjej i vetëm fare,
S'ja çfaq asnjërit dritën magjistare.

Ajo po qeshte, e tha: Tashi kupton
Pse ta zbulova aq pak këtë pëlhurë!
Sapo shikon që rëndë më s'gabon,
Sapo më s'je çunak, ti, si moskurrë,
Një mbinjeri vetveten e beson
Dhe nuk përmbush detyrën posi burrë!
Sa shquhesh ti ngado për ndonjë vlerë?
Kupto, jeto në paqe me të tjerë!



Më fal, bërtita, s'kisha keqmendim;
T'i hap së koti syt' e mi përherë?
Vullnet gazmor jeton në gjakun tim,
E njoh dhuratën tënde plot me vlerë!
Të tjerët do t'i mbush me atë bekim:
Më s'do ta fsheh talentin asnjëherë!
Kërkova rrugën aq me dashuri,
Dhe mos t'ua them vëllezërve të mi?

Dhe siç po flisnja, Qënj' e mrekulluar
Më pa me zemër dhe me mëshirim;
Në syt' e saj sakaq pata lexuar,
Ç'far kisha bërë drejt, e ç'far gabim.
Më qeshi, e ndjeva veten të shëruar,
Për gas të ri m'u ngrit mendimi im;
Tashi pra mundnja, me besim paanë,
T'i afërohem dhe t'a shoh që pranë.

Ajo e zgjati dorën që ta kapë
Të lehtë si dhe pahun avullor;
Dhe 'duk' e prekur fillmëndafshtën napë
Kjo shkriu — u zhduk rrethimi mjegullor.
E shtinje syrin mbi luginë prapë,
Mund ta sodisnja qiellin madhështor:
Asaj i derdhej cipa m'e kulluar,
Rreth shtatit t'hijshëm duke valëzuar.

Të njoh, ta di çdo dobësi të kotë,
T'i di të mirat që ti ke gjithnjë
— më tha kështu, përjetë e ndjej si thatë, —
Pra merr ç'të taksa prej qëkuri: asgjë
Nuk i mungon të lumturit në botë,
Që merr këtë dhuratë q'u përbë
Me muzg mëngjesi e diellë qartësie:
Prej së vërtetës, cipë poezie.

Kur ti dhe miqtë ndjeni zagushi
Në mes të ditës, hidhe atë në erë!
Sakaq ju përkëdhel një freskësi,
Një afsh e duf prej lulesh plot me erë,

Pushon t'ju shqetësojë dheri i zi,
Si shtrat i butë bëhet varri i mjerë,
Qetohet val' e jetës së tërbuar,
Dhe dita e nata ndritin pa pushuar.

Pra hajni, shokë, kur duke rënduar
Ngarkes' e jetës shumë ju mundon,
Kur udhën tuaj fati i mrekulluar
Me lule e pemë t'arta jua bekon,
Drejt ditës s'ardhme shkojmë të bashkuar!
Ajo në jetën vjen na lumtëron
Dhe nipërve, kur t'ikim përgjithmonë,
Iu bëftë gas dhe dashuria jonë.



# KËNGË

## MIRËDASHËSVE

Vjershëtorët s'rrinë t'heshtur,
Flasin midis nesh pareshtur;
Duhet sharj' e lavdërim!
S'e do prozën as secili,
Po i përshtatet trëndafili
Pranë Muzash në blerim.

Ç'kam gabuar, ç'kam kërkuar,
Ç'kam pësuar, ç'kam jetuar,
Bëhen lule për sevda;
Pleqërinë e djalërinë,
Fajin e shpirtmirësinë.
Vjershërimi i nxjerr në pah.

## AMADISI I RI

Seç më mbyllën si çunak
Në një burg të zi;
Vite e vite, zemërak,
N'atë vetësi,
Mbeta si në bark.

Po ti nuk më ndenje larg,
O moj fantazi:
Posi heroj dashurimtar —
Princ' i math Pipi —
Dola shtegëtar.

Ngrita dhe kështjella plot,
Prap' i bëra hi,
Vrava sprija tërë ndoht,
Tërë vrer të zi,
Me guximin tim

Dhe princeshën-Peshk, si krim,
Munda ta shpëtoj;
Në tryezë ajo peri
Bujarisht më ftoj,
Oh, se ç'ëmbëlsi!

Puthj' e saj ish ambrozi,
Verë plot me zjarr.
Ah! e desha pa kufi!
Dielli shkëlqimtar
Derdheshe prej saj.

Ah! kush ma rrëmbeu pastaj?
Si nuk e ndaloj
Lithk' e shpirtit magjistar?
Ku është vënd' i saj?
Ç'rrugë pra të marr?



## KRISTJA

Kaq herë zhytem në mendime
Dhe gjaku më rëndon!
Po kur jam pranë Kristes sime,
Çdo gjë ze më këndon.
E shoh këtej, e shoh matanë
Dhe nuk e di përse,
Dhe si e ka e në çdo anë
Më mbush me kaq hare.

Syzezë krejt e lozonjare,
Dhe vetullzezë krejt,
Më çelet zemra vetmitare
Kur ja shtje sytë drejt.
Ku skuq kjo gojë siç ma kënda,
Dhe faqk' e rrumbull plot?
Ah, dhe diçka 'sht' e rrumbull brënda,
Nuk ngopet syri dot!

Dhe kur pastaj mund ta kap lehtë
Në dans rinor gjerman,
Shkon puna paq posht' e përpjetë,
Asgjë nuk më përmban!
Dhe kur nga zjarri i bje zalia,
Në vrullin që më s'pyet,
E marr mes krahave të mia,
Jam mbret me të vërtet!

Dhe kur më vjen e përmalluar
Dhe s'pyet për asnjeri
Dhe i jap sakaq duk' e shtrënguar
Një puthje me fuqi,
Ze më përshkon si një shigjetë
Në tërë trupin tim;
E jam i fortë e jam i zbetë,
Kam dhëmbje e kam dëfrim!

Do shum' më tepër zemr' e ngratë,
S'më ngop kjo dashuri;
Sikur ta kisha dhe një natë,
Nuk trëmbsha kurrsesi
Them të më vijë ajo ndonj'herë.
Se vetëm s'mund ta mbaj;
Në mos m'u shojtë dhëmbj' e trerë,
Do vdes në gji të saj.



## SHPËTIM

Më la pra vajza pabesisht,
Kjo gjë më pat trishtuar shumë;
Ahere vajta tek një lumë.
Po rridhnin ujrat qetësisht.

Qëndrova atje plot dëshpërim;
Në kokë kisha një rrëmujë,
Dhe ment u hodha brenda n'ujë,
Nga llokoçitj' e trurit tim.

Po befas ndjej se diç thërret
Kur isha për këtu drejtuar
Më tha një zë i mrekulluar:
«Ësht' uji i fellë dhe fundosesh»

Dhe gjaku trupin ma përshkon,
Dhe shoh se ish një çupurlinë;
E pyes: Si quhesh ti? «Katinë!» —
Katinë! Oh, sa më gëzon.

Ti po më ndal nga mort' i zi,
Ti jetën sot ma ke shpëtuar;
Po shumë pak më ke dhuruar,
Më jep dhe fat e lumtëri!

Pastaj ja thashë vrerin tim,
Ajo vështroi për tatëpjetë;
E putha dhe më puthi nxehtë,
Dhe vdekje s'pash as n'ëndërrim

## BIRI I MUZAVE

Nër male e gjelbërime,
Shtegtoj me këngën time,
Bëj udhë kënd më kënd!
Pas taktit valëzohet,
Pas masës drithërohet
Çdo qënie dhe çdo vënd.

S'duroj e nuk më pritet,
Që kopshti të gatitet
Me lule dhe blerim.
Për to këndoj pareshtur,
Dhe kur vjen dimr' i heshtur
Këndoj plot ëndërim.

Këndoj kudo në botë
Me akullin e ftohtë,
Ç'dëfrim e bukuri!
Po dimri ka mbaruar,
Dhe kodriz' e punuar
Më mbush me gas të ri;

Se nënë blir me hie,
Takoj një zagan [1]) rinie
Dh' e mbush me gas të ri.

1) Zagan = turmë



Tutkuni çun bumbehet
Dhe vajz' e rëndë kthehet
Pas s'ëmblës melodi.

Ju krahalehtë e ngrini,
Në fushë e mal e shpini
Djaloshin — mrekulli
O Muza, plot bekime,
Kur prapë vashës sime
Do t'i pushoj në gji?

## KËNGË ALTERNATIVE DANSI

### Indiferentët.

Haj, moj e bukur, ti haj të dansojmë;
Dansi i ka hije festimit gazmor.
Mund të më jesh, në mos qënç, dashurore,
Dans do të heqim sikur dhe mos jesh.
Haj, moj e bukur, ti haj të dansojmë;
Dansi festimit i sjell lavdurim.

### Të ndjenjëshmit.

Festat, e dashur, pa ty ç'do të qenë?
Dansi, e ëmbël, pa ty ç'do të qe?
Nuk do dansonja, sikur mos më deshe,
Festë unë kam, kur ti mua më do.
Festat, e dashur, pa ty ç'do të qenë?
Dansi, e ëmbël, pa ty ç'do të qe?

### Indiferentët

Leri të shmallen, ne le të dansojmë!
Zemr' e përmallshme s'tërhiqet për dans.
Kurse me gas e vërtitim ne vallen,
Futen të tjerët në pyll e në terr.
Leri të shmallen, ne le të dansojmë!
Zemr' e përmallshme s'tërhiqet për dans.



### Të ndjenjëshmit.

Le të vërtiten, ne le të baresim!
Se dashuria 'shtë dans qiellor.
Pranë 'sht' Amori, i dëgjon se si tallin,
Vjen e hakmerret, hakmarret fort shpejt,
Le të vërtiten, ne le të baresim!
Se dashuria 'shtë dans qiellor.

## I VETË-GËNJYER

Vështroj se perd' e fqinjës lot,
Ngadal, me fshehtësi;
Ajo tërthoras po vëren,
Në ndodhem në shtëpi,

Dhe në se shpirti i em xheloz
Që ju pat shfryrë sot,
Në zemrën time, ashtu si ngjet,
S'po më platitet dot.

Po vash' e re, për fat të keq,
Aspak këtë s'e ndjen.
Sepse veriu, tashi në muzg,
Ndaj perdes shkon e vjen.



## NXËNËSI ARGJËNDAR

Kjo fqinja ime — kaq e dashur,
Dh' e zellshme e plëngëtore! [1])
Sa ze punoj, un' i shtje sytë
Drejt saj në tregëtore.

Dhe bëj nga fijet e floririt
Unaza dhe zinxhirka.
Kur do të bëj, ah! dhe nj'unazë,
Ta mbajë Katerinka?

Sa vjen e i hap ajo kanatat,
Sulmon qyteti brënda,
Kërkon e ble prej tregëtores
Artikujt q'i do kënda.

Dh' ahere ndonjë fije t'artë
Un' e limos si dua.
Buçet për shkak të tregëtores
Patroni i keq me mua!

Ajo fillon (kur më s'ka blerës)
Të tjerri me dëshirë.
Kuptoj se çfar kërkon të bëjë:
Ka shpresë vajz' e mirë.

1) nikoqire

Mendoj, kur ajo shkel me këmkën,
Në pulpat vogëloshe,
Dhe në një palë zharetiera
Për vajzën bukuroshe.

Ajo përshkon nër buzë perin,
Se do që ta provojë,
O, sikur t'isha peri i lumtur,
Ta puthnja mu në gojë



## NDJENJA TË NDRYSHME NË NJË PJACË

### Vajza

E pashë! E pashë!
O ç'është kjo thashë?
Ç'vështrim qiellor!
Më vjen i papritur,
E pres e tronditur,
Lëkundem me zor.
Seç' ëndr' e gabuar!
Ju drurë t'uruar,
Ma fshihni gëzimin,
Gëzim vajzëror!

### I dëshëruari

Me vojtj' e me shpresë
Mëngjesit me vesë
Ja them fatin tim.
Nga turma e paçmuar,
Po lidh këmb' e duar,
Në heshtj' e durim.
O shpirt ëndërimi,
O heshtë dhe fshihmi
Mjerimet e mia,
Ma fshih çdo gëzim.

### Djaloshi

Këtu do më duket!
E pashë të zhduket
Me sy dashuror.
Më doli e papritur,

E prita i tronditur.
Dhe i turpshm' e me zor.
Ësht' ëndr' e gabuar?
Ju drurë t'uruar,
Ma gjeni pra vajzën,
Gëzimin rinor!

### Gjahtari

Sot jam i shpërblyer
Me prejë të vyer,
Me shum' shërbim.
Shërbenjësi — i lumtë!
Sjell gjahun e shumtë,
Çapitet si trim.
Po gjej si përhera
Dhe shpeshë të tjera!
Pra rroftë gjahtari,
Me fat e gëzim.



### KUSH BLE AMORETA?

Nga gjith ky mall i bukur
Që sot në treg shikoni,
Asgjë s'do t'ju pëlqejë
Më shumë se ky joni;
Që vjen nga Vënde t'huaj.
Ju këngën na dëgjoni!
Gjith këta zogj të bukur
Ne i kemi për të shitur.

Më parë shihni zogun
E madh e të gëzuar!
Ay nër pemë e fletë
Vjen poshtë pa përtuar;
Dhe prapë e gjen në majë.
O, ç'zog për t'u lëvduar!
Po ne për të s'po flasim!
E kemi për të shitur.

O, shihni-e vogëloshin!
Na mbahet mëndjemprehtë!
Siç vete e vjen i madhi,
Nuk ka dhe ky të qetë.
Tregon kur ësht' i vetëm
Vúllnetin e vërtetë!
Po ne dhe vogëloshin
E kemi për të shitur.

Shikonie pëllumbeshën,
Guguçezën e mirë!
Se vajzat janë t'urta,
Ju mbushin çdo dëshirë.
Ajo do të spastrohet,
T'i ndrijë pend' e dlirë.
Këtu ne bukuroshen
E kemi për të shitur.

Nuk i lëvdojmë zogjtë —
Se kurrë ata s'gabojnë!
Ata i tërheq e reja,
Po besë nuk tregojnë...
Se kanë pëndë e kraha
Dhe shkojn' e fluturojnë.
Oho, se ç'zogj të rrallë!
Se ç'blerkë e mrekulluar!



## LAMTUMIRË

Lermja syrit lamtumirën,
Që me gojë s'e them dot!
Lamtumira nuk durohet,
Dhe një burrë unë jam sot.

Në këtë orë të trishtuar
Dashuria s'ëmbëlson,
Ësht' e ftohtë puthja jote,
Dora jote s'më shtrëngon.

Oh, dikur një puthj' e fshehtë
Ç'më dëfrente vetvetiu!
Ç'na gëzojnë manushaqet.
Që në Mars i mbledh njeriu!

Sot për ty s'po bëj kurorë,
S'këput trëndafil të ri.
Parëverë 'shtë, Franciskë,
Po për mua vjesht' e shi.

## NAT' E BUKUR

Le kasollen e qetuar,
Vashëzën në vetësi,
Shkoj me hap të padëgjuar
Nëpër pyll e terr të zi;
Luna shket nër dushqe e fletë,
Fryn zefiri pa pushim,
Dhe mështekat ulen lehtë,
I shtrojn' afsh me kundërmim.

Ç'më dëfren kjo freskësirë,
Kjo magji, kjo fshehtësi!
O, ç'ma mbush kjo nat' e dlirë
Shpirtin tim plot lumtëri!
Natë e ëmbël sa s'ka fjalë;
Po njëmijë si këtë
Mbaj, o qiell, veç të më falë
Vasha ime vetëm një.



## GËZIM DHE ËNDËRIM

Ti n'ëndër shpesh na pate parë
Si shkelnim për martesë altarë —
Si grua ty, si burrë mua.
Duke treguar sa të dua,
Të putha fort në fshehtësi
Kur s'na shikonte asnjë njeri.

Gëzimi që ne patëm ndjerë,
Dëfrim' i ëmbl' i pandërprerë
U zhduk, si koha, me shijimin.
Ç'dobi që jam duke shijuar?
Çdo puthje shkon si nj'ëndërim,
Dhe shkon si puthja çdo dëfrim.

## KUJTIM I GJALLË

Kush fjongon vajzës t'ja rrëmbejë,
Sikur me zor, sikur me lejë —
Për të, besoj kjo është' e vlefshme
Dhe shpirti i em ja dëshiron.
Unazë e shallë e zharetierë
Nuk janë gjërëra pa vlerë,
Veçse për mua kjo s'mjafton.

Nga trup' i saj më pat dhuruar
(Ashtu si me të kundërshtuar)
E dashura diçka të gjallë —
Dh' ajo stoli s'vlen kurrsesi.
Më qeshet nga rrëmbimi i kotë!
Se mua flokët hijeplotë
M'i fali vajza si peri.

Sikur të t'humbnja, o Dashurore,
Aspak s'do më shpëtosh prej dore:
Do puth me mall e përkëdhelje
Këtë kujtim që ti më dhe. —
Një fat kam unë e floku i shkretë:
Dikur na rritej jeta vetë
Rreth tij, sot jeta jonë u nxi.

Me të ne qemë lidhur mirë.
Dhe i puthnim faqkat me dëshirë,
Na ndillte nj'ëmbëlsi magjie,
Pushtoheshim me zjarr në gji.
O ti rival, pa cmirë asfare.
Dhuratë e ëmbël kujtimtare.
Kujtona fat e lumtëri!



## LUMTËRI LARGËSIE

Pi, djalosh, gëzim të shenjtë
Prej së Dashurës së shtrenjtë
Ditë e natë me lezet;
Ja kalo çdo dashurori;
Po m'i ëmbël është zori
Larg së Dashurës së vet.

Koh' e qetë e largësia,
Posi yjet me shkëndia,
Qetësojnë shpirtin tim.
Gjith më shumë mallëngjehem,
Po dhe gjith m'i lehtë ndjehem
Gjith më fellë kam dëfrim.

S'e harroj atë përjetë;
Dhe përkundr' ha bukë i qetë,
Jam shpirtlirë e plot gëzim;
Magjistar' e pakuptuar
Ma bën zjarrin t'adhuruar,
Dhe lakmimin ëndërim.

Dielli lart duk' e rrëmbyer,
Valëzon duke dëfryer
Nap' e resë cak më cak,
Posi zemra ime e qetë.
Un' e dua atë përjetë
Dhe pa cmir e frikë aspak.

## NAT' E PARË

Te dhom' e fjetjes, larg nga festa,
Amori i dashur po përgjon
Mos shtratin nusëror së fshehta
Vjen ndonjë mik e turbullon.
Me fërfëllim të shenjtëruar
Ndrin flak' e zbetë para tij.
Temjani vlon që ju, siç duhet,
Të shkrihi krejt në dashuri.

Se si po dridhesh kur vjen ora
Q'i zhduk dasmorët përgjithënjë;
Si të shtje flakën goj' e bukur
Që s'flet e s'refuzon asgjë!
Ti ze nxiton, që të fundosish
Përplot në këtë shenjtërim;
Nga dor' e rojës zbehet drita
Si një kandil që s'bën ndriçim.

Si djeg prej puthjeve të tua
Fytyra e gjiri nusëror!
Ngurim' i saj ze bëhet drithmë,
Detyrë, sulmi burrëror.
Amori shpejt ndihmon ta xhveshish,
Ësht' aq i shkathët sa dhe ti
Pastaj mbyll sytë dhe i përulur
Bën sikur s'sheh me dhelpëri.



## PAFAJËSI

Çfaqje e bukur shpirtërore,
Krua i pastër' e ëmbëlsi!
Mbi Bayronin dhe Pamelën [1])
Ideal dhe rrallësi!
Kur një tjetër zjarr bën flakë,
Drita jote e ëmbël shkon;
Kush të ndjen, nuk të di fare,
Kush të di, nuk të kupton.

Perëndeshë parajsore,
Ti jetonje veç me ne;
Shkel livadhin para diellit
Në mëngjes me shumë hare.
Të shikon veç vjershëtori
Nëpër mjergull, nëpër re;
Vjen Febusi, më s'ka mjergull,
Dhe në mjergull ti më s'je.

1) Pamela, roman edukativ i poetit anglez Richardson.

## SI I VDEKUR

Vajtoni, vajza, Amorin përmi varr.
Se prej asgjëje vdiq këtu papritur.
Po vdiq vërtet, s'e them dot me karar·
Se ngjallet shpesh papritur e pa ditur.



## SË ZGJEDHURËS

Dora dorën, buza buzën.
Vajz' e dashur, mbamë besë!
Lamtumirë! Ndaj shkëmbënjve
Dashurori shkon me shpresë;
Po në prektë pas furtunës
Skelën që shikon nër sy,
Zotërit e turbullofshin
Në shijoftë gjë pa ty.

Kush guxon, po ka fituar,
Gjysma, do të thotë fundi!
Yjet, un' i kam si djellë —
Veç frikoci s'sheh gjëkundi.
Sikur t'isha pranë teje,
Do të ndjenja zemërim;
Po kjo largësirë e madhe
Veç për ty më jep guxim.

E kam gjetur dhe luginën,
Ku së bashku do shtegtojmë;
Lumëthin në mbrëmëherë
Se si shket do ta shikojmë.
Këta plepa mbi livadhe,
Këta lisa në blerim!
Ah! pas tyre do të gjenim
Një kasolle për strehim.

## HUMBJ' E PARË

Ah, po ku jan' ato ditë,
Koh' e parë e dashurisë,
Kush ma sjell, ah, atë orë
T'asaj kohe plot magji!

Unë e qaj i vetm' e i gjorë,
Dhe në terr të madh pa dritë.
Mallkoj fatin tim të zi.

Ah, po ku jan' ato ditë,
T'asaj kohe plot magji!



## AFËRSIA E TË DASHURIT

Gjith të kujtoj, kur dielli mi dete
Ze ndrin për mua;
Gjith të kujtoj, kur hënëza nga retë
Shkëlqen mi krua.

Gjith të kujtoj, kur pluhuri mi shtigje
Ze ngrihet n'erë;
Në natë e terr, kur ec nër shtigje e brigje
Shtegtari i mjerë.

Gjith të dëgjoj, kur ngrihet val' e thellë
Duke buçitur,
Kur ze përgjoj mes pyjeve pa diellë
Dhe të nemitur.

Gjith jam me ty: dhe ngado qofsh larguar,
Të shoh matanë!
Po ngryset: ndritin yjt' e pambaruar —
O, t'ishe pranë!

## SË LARGUARËS

Të humba pra me të vërtetë?
Më ike, e bukur, përgjithnjë?
Gjith tingëllon në vesh të shkretë
Çdo fjalë e folur nënë zë.

Ashtu si në nj'agim të dlirë
Së koti një udhëtar shikon,
Kur, atje lart në kaltërsirë,
Lauresha sipër tij këndon:

Kështu shikoj nga dhëmshuria
Në fush' e mal e pyll të zi;
Të flas prej këngëve të mia;
O, haj, e dashur, përsëri!



## MBANË LUMIT

Fundosuni në det t'harrimit,
O vargje t'ëmbël dashurie!
Asnjë djalosh mos ju këndoftë,
Dhe asnjë gojë vajzërie.

Ju foltë veç për Dashuroren,
Që sot po qesh me zjarrin tim.
Ju pata shkruar përmi ujë;
Pra shkoni n'ujë dhe n'harrim!

## NDRYSHIM

Mi zallin e lumit dëfrej duke u shtrirë!
Në krahat e mia pres valën e lirë,
Që ngjesh e përmallshme krahrorin e saj
Dhe zbret më përposh mëndjelehtë pastaj;
Afron val' e dytë, më çik edhe shkon:
Kështu ndjej gëzimin që shkon e ndryshon.

Po ah, ti kaq hidhur e tinës e kot
Pret orët e jetës që shkon e s'rri dot,
Se ty dashurorja m'e ëmbël t'harron.
Mezi puthe dje ti një vajzë të dlirë,
Ze puth sot një tjetër më shumë e më mirë.



## KËSHILLË

Ç'të bëjë, ah, njeriu i shkretë?
Duhet pra të rrijë i qetë?
Kacavirur të qëndrojë?
A mos duhet të sulmojë?

Duhet ngritur një shtëpi?
Duhet çadr' e varfëri?
Duhet shkëmbit t'i besosh?
Vetë shkëmbi bje përposh.

Nuk zgjeth dot njeriu i mjerë!
Sikushdo le të mendojë,
Sikushdo le të qëndrojë,
Dhe kush rri, le të mos bjerë!

## VOZITJE E LUMTUR

Dhe retë përhapen,
Dhe qielli u kullua,
Vargonjt' e përmbajtur
Eoli i shpërndan.
Furtuna ze tundet,
Lundrari ze shkundet,
Përpara! Përpara!
Dhe valën e ndan,
Ja, toka u afrua!



## KUJTIM

Do gjithnjë të shtegëtosh?
Ç'kërkon fatin tjetërku?
Mëso fatin ta kuptosh,
Sepse fati është këtu.

## DASHURI E RE, JETË E RE

Zemër, o moj zemra ime,
Ç'po të shtyn me kaq rrëmbim?
Ç'jetë e huaj! Sa ndryshime!
S'e kap dot këtë kuptim.
Iku, ç'pate dashuruar,
Iku, ç'të pat turbulluar,
Dhe çdo zell e qetësi —
Ah, si ndodhi kjo magji?

Të shtrëngon ty vajzëria,
Dhe ky trup me naze plot,
Syri i ëmbl' e mirësia
Me fuqi që s'mbahet dot?
Kur provoj që t'i largohem,
Të shpëtoj, të burrërohem,
Rruga ime përsëri
Më shpje tek ajo në gji.

Dhe me këtë pe t'uruar
Që s'këputet kurrsesi,
Më mban vajz' e adhuruar
Si një skllav në robëri;
Dhe jetoj, si prej magjie,
Fare pas kësaj perie,
Aq ndryshova, ah, nër këto!
Dashuri! ti më lësho!



## BELINDES

Ç'më tërheq aspak pa kundërshtuar
Ah, n'atë sukëlqim?
S'isha unë, i lumtur, atë natë,
Djalë i mirë trim!

Mbyllur tinës brenda dhomës sime,
Ku bij hën' e re,
Krejt i zhytur n'atë dritë t'artë,
Zura që të fle;

Ndjeva n'ëndër, duke u lumtëruar,
Orë plot dëfrim,
Më pat ndritur pamja jote e ëmbël
Mu në shpirtin tim.

Jam akoma ay, që nër kaq drita
Ti më ban të los?
Që kaq shpesh e ngreh përball armiqve
Posi një fatos?

Nuk ja ndjej, s'ja ndjej më parëverës
T'ëmbëlën fytyrë,
Ku je ti, o dashuri, o engjëll,
Ku je ti, natyrë!

## KËNGË MAJI

Si ndrin kjo bota
Me plot shkëlqim!
Si shkrep ky dielli,
Si qesh, blerim!

Shpërthejnë lulet
Nër degë plot,
Njëmijë zëra
S'përmbahen dot.

E gas e dehje
Në fund, në gji.
O dhe, o diellë,
O lumtëri!

O, dashuria!
Kaq nur e hir,
Si re mëngjesi
Atje n'ethir,

Bekon hirplote
Fush' e blerim,
Botën e dehur
Plot lulëzim.

O vashë, vashë,
Syndrituro!
Se sa të dua!
Se sa më do.



Siç do lauresha
Këngë e liri,
Lul' e mëngjesit
Erë e stoli,

Të dua unë
Me gjakun tim,
Ty që dëshirë,
Zjarr e kuxim,

Për vargje e valle
Më jep kurdo.
Gëzofsh përjetë,
Që kaq më do!

## ME NJË GJERDHANKË TË ARTË

Kjo fletë ty të sjell gjerdhankën,
Që, duke u hapur mirë e mirë,
Me njëqind hallkëza të ngjitet
Rreth qafës sate ka dëshirë.

Ti merrja mëndjevogëlcakut,
Se me gjith shpirt vjen të ta japë;
Një gjë stolie 'sht' ajo ditën,
Në mbrëmje mund ta hedhish prapë.

Po në të sjelltë ndonjë tjetër
Gjerdhan të rëndë që kushton,
S'ta marr për keq, o moj Lizetë,
Kur të të shoh se po dyshon.



## LOTKES

Në gëzim e në vështirësi,
Në mjerim të zemrës së përzjerë,
Të kujtoj, o Lotkë, të kujtojmë si,
Që të dyve n'atë mbrëmëherë
Na dhe dorën me përzemërsi,
Dhe mes fushës së bleruar,
Mes natyrës së mërekulluar,
Ti na preke duke na zbuluar
Atë shpirtin tënd plot dashuri.

Kam kënaqësinë që s'gabova,
Që prej orës më të parë ty,
Me atë zjarr të shpirtit tim nër sy,
Mirë dhe përzemërsisht të çmova.

Rritur urtë e qetë dhe shtrënguar,
Ne na hedhin drejtpërdrejt në botë;
Njëqindmijë vala duke shkuar
Na kënaqin, a na shtrydhin lotë
Na lëkundin fellë e me çdo ças
Zemra jonë vete e vjen' çapras;
Ndjejmë shumë, dhe çfar patmë ndjerë,
Shpejt e mbraps rrëmeti me poterë.

Un' e di, po, se na kap gjithmonë
Ndonjë dhëmbje, ndonjë shpresë e re;
Lotkë, kush e njeh mendimin tonë?
Lotkë, zemrën tonë kush e njeh?
Ah, kjo do të desh të njihet — të kalojë
Drejt në zemrën e ndonjë krijese;
Dhe, pa drojtur, dyfish të shijojë
Çdo mundim e çdo gëzim jetese.

Dhe vështrimi bën kërkim të kotë
Rreth për qark dhe mund që gjen çdo gjë;
Shkon m'e hijshmja jetë kësisoj pa lotë
Dhe pa qetësi që ç'ke me të;
Për mërzitjen tënde të përjetshme
Sot të mpraps ajo, që të tërhoqi dje.
Mund t'ja falish zemrën, sado t'etshme,
Botës që ty të gënjeu pa fre,
Dhe, në dhëmbje e lumtëri,
Të tregoj gjith një të ngurtë qetësi?
Ja, kështu ze mprapset shpirti i shkretë,
Kurse zemra mbyllet përgjithjetë.



## MI LIQER

Me ushqim të freskët, gjak të ri
Po mbushem liriplot:
Se sa gëzim e mirësi
Më fal natyra sot!

Lëkundet lundërza mënge,
Lopata rreh ngadal,
E shtatvigan gjer përmi re
Vërsulet mal me mal.

Syt' e mi, përdhe pse bini?
Ëndra t'arta, prapë vini?
Larg! moj ëndr' e artë ti:
Dhe këtu ka dashuri!

Mjergullat thëthijnë
Pamjen atje larg,
Përmi vala ndrijnë
Yjet varg e varg.
Dhe liqeri zgjohet
Shpejt nga djep' i tij
Pema pasqyrohet
Plot me bukuri!

## SULEJKA

Ç'thotë ashtu kjo rëgëtima?
Fryn prej Lindjes lajm i mirë?
Krahu i saj me fërfëllima
Freskon zemërën e vdirë.

Lot me pluhur e me rërë,
I ngreh sipër lozonjare,
Shtyn në pjergullën e gjërë
Mizërinë këngëtare.

Ja zbut djellit nxehtësinë,
Më freskon mi faqe e gushë,
Fryn e shkon e puth hardhinë
Nëpër kodër, nëpër fushë.

Dhe me duf e afsh të lehtë
Sjell nga miku plot të fala;
Sjell pa u errur kodr' e qetë
Plot të puthura të vala.

Shko më larg kështu pa parë!
Shërbe shokë e të trishtuar:
N'ata mure shkëlqimtarë
Pret djaloshi i dashuruar.

Ah, se lajmin e vërtetë,
Ku freskohet dashurija,
Ma flet goj' e tija vetë,
Ma jep vetë buz' e tija.



## NDJENJË VJESHTE

Më shumë gjelbëroni, ju fletët e rrushit,
Këtu në vreshtoren
Sipër dritares sime!
Më ngjeshur fryhuni,
Ju kokrra binjake, dhe piquni
Më shpesh dhe shkëlqeni më plot!
Ju klloçet juve vështrimi lamtumironjës
I dritës-mëmë të diellit, ju përkëdhel
Qielli i hirshëm
Me plotësinë e tij jetdhënëse;
Ju freskon mirëdashësja hënë
Me frymën e saj magjistare,
Dhe ju vesojnë, ah!
Nga këta sy
Lotët e rrëkeshme
Të dashurisë përjetësisht gjallëronjëse.

## NGUSHËLLIM MES LOTËSH

Përse po dukesh kaq me vrer,
Kur bota bën gëzim?
Kuptohet shpejt se syt' e tu
Kan' qarë pa pushim.

«Dhe në kam qarë pa pushim,
Kjo mua më vështron,
Se loti rrjedh i ëmbël fort,
Në shpirt më lehtëson».

Të ftojnë shokët tërë gas:
O, eja pra me ne!
Dhe në paç humbur çfardo gjë,
Ti folë e na rrëfe.

«Ju bëni zhurmë e s'dini aspak,
Të mjerin ç'më mundon.
Ah jo, s'kam humbur un' asgjë;
Dhe shumë më mungon».

Po merre veten shpejt e shpejt!
Ti je pra një djalosh
Dhe mosha jote ka fuqi,
Guxim që të fitosh.

«Ah jo, nuk mund që ta fitoj,
Së largu s'mund ta ndjell.
Qëndron aq lart, shkëlqen aq fort,
Si ylli atje në qjell».



Nuk duhen yjet për fitim,
Veç drita na gëzon,
Dhe plot dëfrim ne shohim lart
Kur nata shkëndijon.

«Dhe plot dëfrim un' atje lart
Përdita rri vështroj;
Ma linj natën për vajtim,
Sa mund që të vajtoj».

## MALL

Ç'ma prek kështu zemrën?
Ç'më bën që të zjej?
Ç'më shtyn të largohem
Prej dhomës përtej?
Po ndrit cip' e reve
Rreth shkëmbit atje!
Atje do të vete,
Atje përmi dhe!

Ja, korbërit n'erë
Valojnë me gas;
Përzjehem mes tyre,
Mes tufës humbas
Dhe malit e murit
I vijmë përqark;
Ajo 'sht' atje poshtë,
Ajo 'sht' atje larg.

Ajo vjen e endet;
Un' ik, fluturoj,
Në pyllin e dëndur
Si zog po këndoj.
Dh' e ndal ajo hapin,
E qesh e përgjon:
«Ay këndon ëmbël,
Për mua këndon.»

Po i lan perëndimi
Kodrinat me ar;
Sodet bukuroshia
Me shpirt mendimtar.



Dhe shkon buzë lumit
Mi bar e stoli
Dhe hapat i zhduken
Në terrin e zi.

Sakaq unë çfaqem
Si yll shkëlqimtar.
«Kaq afër, kaq largë,
Ç'ndriçon posi zjarr?»
Ti fort' e mahnitur
Shkëlqimin e pe;
Po mua të lumtur
Nër këmbë më ke!

## ZEMRËS SË ARTË QË AY MBAJTI NË QAFË

Ti kujtim i lumtëris' së shuar,
Që rreth qafës po të mbaj gjithnjë,
Mund ta zgjatish, duke ma kujtuar,
Dashurinë që s'këthehet më?

Ika, Lili! Me gjerdhankën tënde
Nëpër male e pyje e vënde e kënde
Do të rend i mbushur me kujtime!
Zemr' e Lilit s'mundi kaqe shpejt
Të shkëputet ah! prej zemrës sime.

Jam si zogu, q'e këputi perin,
Dhe në pyll e mori gjithë vrerin,
Gjithë turpin, burgun për çdo ças:
Se në këmbë i mbeti peri pas;
S'është zogu i lirë e i pangarë,
Me q'atë dikush e pat më parë.



## ËMBËLSI MALLËNGJIMI

Mos u thani, mos u thani,
Lotë të dashuris' së përjetëshme!
Ah, syrit të gjysmëtharë
Sa shkretë, sa e vdekur i duket bota!
Mos u thani, mos u thani,
Lotë të dashuris' së pa fat!

## KËNGË NATE E GJAHTARIT

Në fushë un' ik me sy mizor,
Me pushkëzën gati,
Me shpirt të qetë e engjëllor
Më del përpara ti.

Dhe shkon në fushë e valth të ri
Me çapin mitur ak,
Ah! mua q'ik me shpejtësi
S'më ndjen ti vallë aspak?

S'e sheh njeriun, që kapton
Plot helm e gjëmë plot,
Dhe Lindje e Perëndim përshkon,
Ndaj po të le ty sot.

Më vjen, se hënën po sodas
Kur mënt' i shpje tek ti;
Dhe mbushem me durim e gas —
Ç'më ngjau kështu, s'e di.



## HËNËS

Mbush luginë e pyll të zi
Prapë me shkëlqim,
Ma ngreh shpirtin përsëri
Prej mjerimit tim.

Dhe më qetëson më nge
Me vështrim qiellor,
Si një mik që vjen e shtje
Gas në kraharor.

Ndjej gëzim e ndjej maras,
Si nj'herë e tashi,
Dhe kështu me dhëmbje e gas
Rroj në vetësi.

Rridh, o lumë, pa pushim!
Gas për mua s'ka;
Vate puthja plot dëfrim,
Besa që më dha.

Unë kisha lumtëri,
Mall me jetë plot,
Që, për vojtje e vrer të zi,
Nuk harrohet dot.

Rridh, o lumë, pa pushim,
Rridh pa qetësi,
Rridh, e mbushe zërin tim
Plot me melodi!

Kur në terrin dimërak
Egër ti vërshon;
Dhe në zallin pranverak
Lulet i veson.

Lum si kush nga bota u nda,
Dhe pa cmir jeton
Dhe një mik me vete ka
Dhe me të shijon.

Një të fshehtë q'asnjeri,
Ndaj nuk e kupton,
Labirintin mu në gji
Natën ja përshkon.



## SHPRESË

Bëmani, o ju moj duar,
Punën për t'u lumtëruar!
S'lodhem, jo, në këtë botë!
Se nuk është nj'ëndr' e kotë.
Këta bisqe vegjëlie
Do të japin pemë e hie.

## KËNGË PËRVJETORI

Moj fqinjë e bukur, ç'vete e vjen
Mes kopshtit madhështor?
Në ke kujdes për në shtëpi,
Të bëhem shërbëtor.

Iu ngjit garsones im vëlla,
S'e la në qetësi;
Ajo i dha pije për freskim
Dh' e puthi me fuqi.

Dhe kuzinjeres rreth për qark
I vjen im kushëri;
Ay për roston e shpërblen
Me zjarr e dashuri.

Këta të gjashtë u ngjeshnë paq
Me gjellë në gosti;
Një çift i katërt këngëtor
Në sallë u hodh tashi.

Misardhtë! dhe mir' se na vjen,
Mor çift i pestë ti,
Që sjell dëfrim e bisedim
E gas e freskësi.

Për gjë a gjëza, për shaka,
Pat mbetur dhe një çip:
Një çift i gjashtë u çfaq në ças,
U gjet pra dhe ky tip.



Po mbet dhe një mërgim i madh,
M'i miri nga çdo gjë:
Një çift nazik e plotësoj,
Një çift që ç'ke me të!

Le të festohet shoqërisht
Gostia që kënaq,
Dhe çift' i shenjtë shpirtërisht
Le të gëzohet paq.

## RRËFIM I PËRGJITHSHËM

Mblidhuni fisnikërisht
Për rreth fjalës sime!
Se nuk mund t'i gjeni shpesh
Këto këshillime!
Shumë gjëra dëshëruat,
Shumë dëndur e pësuat —
Pritni pra qërtime.

Do të ketë sikushdo
Rast për t'u penduar!
Pandaj, thoni ndershmërisht
Ç'kini mëkatuar!
Prej gabimit plot të metë
Mblidhuni me shpirt të qetë
Për t'u rregulluar.

Po, ne shpesh, pa mbyllur sy,
Kemi ëndëruar,
Nuk e pimë, kur na ftoj
Ver' e shkumëzuar;
Ndonjë grimë dashurije,
Puthj' e shpejtë plot me shije
S'na pat përvëluar.

Mbyllnim gojë e s'flisnim, kur
Lolot i dëgjonim,
Ç'theshin për ndonj' hymn qiellor
Marrëzitë u çmonim,
Dhe për çaste lumtërie,
Që mund t'ishin shkak lavdie,
Llogari kërkonim.



Po n'u falsh ti çfardo faj
Shokëve besnikë,
Ne në kundërshtim me ty
S'do vemë asnjë çikë,
Po veç sipas tërësisë,
Mirësisë e bukurisë
Krejt pikë për pikë;

Për shpirtthatët jetëzinj
Fare s'do t'ja dijmë,
Verëzën që shkumëzon
Nuk do ta lëpijmë,
S'do flirtojmë ashtu nga pakë,
Porse buzët ziarr e flakë
Fort do t'i thëthijmë.

## KËNGË KOPTIKE

Lerni të Diturit duke u qërtuar,
Lerni Mësonjësit plot me dyshim!
Thonë të Urtët, gjithnjë, të bashkuar
Dhe buzëqeshin me plot kupëtim:
S'ndreqen të Marrët, mos prit si nj'i marrë.

Plaku Merlin, n'atë varr të ndriçuar,
Ku, posi djalë, iu pata dëgjuar,
Gjith këto fjalë më pati mësuar;
S'ndreqen të Marrët, mos prit si nj'i marrë!
O ju të Mënçur, me tallje e të sharë
Mbrapsni të Marrët, ashtu siç ka hije!

Dhe përmi male t'Indisë ku ngjita,
Dhe nënë varre t'Egjiptit ku zbrita,
Gjith atë fjalë të shenjtë unë prita:
S'ndreqen të Marrët, mos prit si nj'i marrë!
O ju të Mënçur, me tallje e të sharë
Mbrapsni të Marrët, ashtu siç ka hije.



## VANITAS VANITATUM VANITAS!

S'e çaj më kokën për asgjë,
Hi-hi!
Prandaj po rroj që ç'ke me të,
Hi-hi!
Dhe ay që do të më bëhet shok,
ja merr këtu tok, e pjek këtu tok
Dollinë e verës çok!

Kërkova ar e pasuri,
Hi-hi!
Po humba guxim e lumtëri,
Oji!
Vërtitej ari tej-tëhu,
Dhe kur e kapnja atë këtu,
Më ikte tjetërku.

Kërkova femrat me lakmim.
Hi-hi!
Pandaj më ngjau kaq turbullim,
Oji!
Ajo e pabesa një tjetër desh,
Ajo besnikja gjë s'më thesh,
M'e mira — ku ta gjesh.

Kërkova udhë e udhëtar,
Hi-hi!
Dh'e lashë zakonin atdhetar,
Oji!
Po n'asnjë vënd nuk pata fat,
Ish gjellë tjetër, ish keq në shtrat,
Kuptim për mua s'pat.

Kërkova nder edhe lavdi,
Hi-hi!
Dhe ja ma shkoj një tjetër njeri,
Oji!
Siç isha ngritur lartësisht,
Më shihnin të gjithë cmirësisht,
S'më çmuan drejtësisht.

Kërkova luftë dhe luftim,
Hi-hi!
Dhe patmë shpesh edhe fitim,
Oji!
Iu futmë armikut në vënd të tij,
T'ish tjetri aq mirë, nuk e di,
Dhe humba një kërci.

S'e çava më kokën për asgjë,
Hi-hi!
Dhe po ja shpje që ç'ke me të,
Hi-hi!
Tashi merr fund këng' e gosti,
M'i zbrasni krejt këto dolli,
Dhe bromp! përmbysini!



## GËZIM LUFTE

Më t'idhur gjë në luftë s'di,
Veçse mos jesh plagosur.
Marshon me qejf gjith fitimtar
Në luftë të pasosur!
Lëshon përposh e ringarkon,
Gjë tjetër pa fituar,
Përveç se marshin që mundon,
Mërzi duke pushuar.

Pastaj vjen puna për strehim,
Ngarkesë për fshatarin,
Urrejtje për borgjezin plak,
Fisnikun dhe bujarin.
Ti sillu mirë s'ke shërbim,
Si pjellë trashamane;
Dhe në çdo rast e në çdo vënd
Ha bukë korromane.

— Dhe kur zjen topi më në fund,
Dhe pushka kris menj'herë,
Trumbetat dhe daullja zjen —
Sa qejf gjith kjo poterë!
Dh' ashtu, si lufta e ka zakon,
Rri gati pa pushuar,
Përpara, prapa, ndal, sulmon
Pa kryq në kraharuar.

Ja plumbi i pushkës vërshëllen,
Godet, o Zot, në këmbë
Dhe çdo mundim tashi mbaroj
Dh' ashtu, me shpirt nër dhëmbë,
Na ngrehin shpejt për në qytet,
Që tmerësisht u muar,
Ku gratë e trembura në ças
Na presin shpirtgëzuar

Kur njëra trimit i shërbeu,
Disi dh' e pat fituar,
I sillet fqinja plot kujdes
Dhe duk' e shoqëruar.
Vazhdon e treta më me zell,
Në fund, s'mungon gjë fare,
Dh' ay na ndodhet mu në mes
Të mbledhjes kujdestare.

Dëgjon dhe Mbreti për kaq qejf,
Kaq: zjarr për të luftuar,
Dhe vijn sakaq kordon e kryq
Mi rrobe e kraharuar.
Më thoni, në ka luftëtar
Më bukur të shpaguar;
Dhe trimi ndahet plot me lot
E nder e i dashuruar.



## TRYEZË E SHTRUAR

Shumë miq kam dashur sot
Në këtë tryezë!
Kam gatitur gjellë mjaft,
Gjah e peshk e shpesë.
Që të gjithë i ftova sot,
Ftesën e pranuan.
Vankë, dil, pa dil e shih!
Shih, mos u afruan!

Çuna t'hijshëm them të shoh,
Që nuk dinë fare,
S'dinë se kur puth një mik
Është gjë bujare.
Që të gjithë i ftova sot,
Ftesën e pranuan.
Vankë, dil, pa dil e shih!
Shih, mos u afruan!

Edhe gra mendoj të shoh,
Që, pasi u martuan,
Ndonse burri doli ursuz,
Gjith e dashuruan.
Un' ato i kam ftuar sot,
Ftesën e pranuan.
Vankë, dil, pa dil e shih!
Shih, mos u afruan!

Djem të rinj kam ftuar sot,
S'janë këmbëngulur;
Po, me gjith kuletën plot,
Sillen të përulur;

I kam ftuar krejt veçan,
Ftesën e pranuan.
Vankë, dil, pa dil e shih!
Shih, mos u afruan!

Burra ftova me respekt,
Që shikojnë t'urtë
Vetëm gratë e tyre, e jo
Ndonjë mëndjeshkurtë.
M'u përgjigjnë ndershmërisht,
Ftesën e pranuan.
Vankë, dil, pa dil e shih!
Shih, mos u afruan!

Dhe poetë ftova sot,
Për dëfrimin tuaj,
Që më fort se këng' e vet
I prek këng' e huaj.
Gjith këta na thanë po,
Ftesën e pranuan.
Vankë, dil, pa dil e shih!
Shih, mos u afruan!

Po nuk shoh të vijë asnjë,
Asnjë s'merakoset.
Supa zjen e përvëlon,
Rostua do ciknoset.
Ah, ç'më tremb kjo llogari,
Bërë pa hanxhinë!
Vankë, Vankë, ç'thua ti?
Nuk besoj të vinë!

Vankë, thirr të tjerë miq,
Ik pa u vonuar!
Le të vijë ashtu siç është
Gjithsecili i ftuar!
Gjith qyteti e mori vesh,
Mirë e ka pranuar!
Vankë, hapi dyert shpejt:
Vinë të nxituar.



## DETYRA

Eja! vera le të rrjedhi!
Mos ta rrudhim sot fytyrën!
Në do të dëfresh me neve,
Fol: e mbushe ti detyrën?

**Njëri**

Dy të rinj me shpirt të mirë
Duheshin që ç'ke me të;
Dje me mall, sot duke shfryrë,
Nesër gjithashtu dhe më;
Kur ajo lëkundte kokën,
Shkulte flokët djali i zi;
Këtë çift un' e pajtova,
Dh' ata kanë dashuri!

**Kori**

Mos u digj aspak për verë!
Shpejt këtu me kupën plot!
Sepse qarjen dhe vajtimin
E ke mbrapsur larg ti sot.

**Njëri**

Pse po qan, o moj jetime?
«Zot! më s'mund të rroj aspak;
Po më katandis tutori,
Që të lyp prak e më prak.»

Un' e njihja rracëndyrin,
U bë gjyq për këtë gjë,
Drejtësia dha vendimin:
Vajz' e shkretë nuk lyp më.

**Kori**

Mos u digj aspak për verë!
Shpejt këtu me kupën plot!
Sepse çarjen dhe vajtimin
E ke mbrapsur larg ti sot.

**Njëri**

Një vogloshi të pambrojtur,
Që dhe s'mund veçanërisht,
Po i vërsulej sot një trasho
Mizorisht e egërsisht.
Unë thashë: do përmbushur
Kjo detyrë që më pret,
Dhe sakaq e prita syve
Gogomelin shpirtlanet.

**Kori**

Mos u digj aspak për verë!
Shpejt këtu me kupën plot!
Sepse qarjen dhe vajtimin
E ke mbrapsur larg ti sot.

**Njëri**

Do të them një fjalë dh'unë,
Ndonse s'bën për bisedim.
Duke i patur punët mirë
Thashë të sjell një shërbim;
Papo s'lashë asgjë mënjanë,
Nuk më shkoj detyra kot:
Gjithsecili desh të hajë,
Dhe të ngrëna patnë plot.



**Kori**

Mos u digj aspak për verë!
Shpejt këtu me kupën plot!
Sepse qarjen dhe vajtimin
E ke mbrapsur larg ti sot.

**Njëri**

Dikush deshte të më ndreqë,
Vepëroj si mos o Zot!
Ngrinte supet, inatosej!
I thesh vetes patriot.
Un' aspak s'ja vura veshin,
shkova drejt me gjith këto:
O budall! ra zjarr! — ti shuaj!
Dhe n'u dogj — ti rindërto!

**Kori**

Mos u digj aspak për verë!
Shpejt këtu me kupën plot!
Sepse qarjen dhe vajtimin
E ke mbrapsur larg ti sot.

**Mjeshtri**

Sikushdo le të na thotë
Ç'i pat vajtur mirë sot!
Ky 'shtë zjarr i madh — dhe flaka
Këngën le ta ndezi plot.
Kush nuk ka vullnet, s'durohet,
Kështu jeta na urdhëron!
Veç gollani 'sht' i përulur,
Sepse burri vepëron.

**Kori**

Mos u digj aspak për verë!
Shpejt këtu me kupën plot!
Sepse qarjen dhe vajtimin
E ke mbrapsur larg ti sot.

## Tre zëra.

Le të vijë pra në sallë,
Plot me gas çdo këngëtor;
Veç ay që na bën naze,
Hyrjen e ka si me zor;
Prapa nazeve të shkreta,
Prapa dhëmbjes, ore mik,
Prapa mvrejtjes ne kuptojmë
Zbraztësi dhe shpirt të lik.

## Kori

Sikush verën do ta pijë,
Po s'pranojmë asnjë poet,
Që vajtimin nuk e mbrapsi
Larg prej vetëhes së vet.



## ERGO BIBAMUS!

Këtu jemi mbledhur për qejf e gëzim,
Dëfreni pra! Ergo bibamus!
Çdo gotë bën tingull, çdo gojë pushim,
Pushtojuni! Ergo bibamus!
Kjo fjal' është' e vjetër dhe fjalë me mënd,
Dhe vlen për fillim e vazhdim kënd më kënd,
Shpërthen një buçim prej të lumturit vënd,
Prej gjoksevet: Ergo bibamus!

E pashë unë vajzën dhe vajza më pa,
Mendova pra: Ergo bibamus!
Dhe kur ajo ëmbël ju puth e shtrëngon,
Dhe kur puthj' e ëmbël e saj ju mungon,
Qëndroni rreth pijes që shpejt ngushëllon
Dhe laguni! Ergo bibamus!

Prej shokëve sot fati im më largon;
Pra ejani! Ergo bibamus!
Po ndahem me trastën që pakëz rëndon;
Dy herë pra, Ergo bibamus!
Kopraci shtrydh jetën e vet për asgjë,
Po i qeshuri gjen ngushëllim gjithënjë,
Gazmori gazmorit i huan çdo gjë;
Pra puqeni! Ergo bibamus!

Ç'të themi për sot, o shokët e mi!
Do thosha veç: Ergo bibamus!
Kjo ditë asnjë dite s'i ngjan kurrsesi;
Prandaj dhe një herë: Bibamus!
Ne mbushemi sot me gëzim dashuror,
Shkëlqen cip' e reve me zjarr ëndëror,
Na ndrit një fytyrë me shpirt qiellor;
Ne pijmë e këndojmë: Bibamus!

## KËNGË SIQELIE

Ju syçkat si ulli!
Kur bëni shënjë,
Rrëzohen kaq shtëpi.
Qytete shemben;
Po muri i dobët fort
Rreth zemrës sime,
Pa ejani nër mënd,
Si të mos binte!



## KËNGË FINLANDEZE

Të më vinte prej së largu
Miku im q'un' e njoh mirë,
Puthjet do t'ja ngjitnja buzës
Së përgjakur dhé prej ulkut;
Ëmbël do t'ja kapja dorën,
Mbushur plot dhe me gjërpinj.

Erë o maj, po të kuptonje,
Do t'i shpinje shumë fjalë,
Sikur dhe ndonjë të shuhej
Mes dy zemrash q'u larguan.

S'më tërheq e ngrën' e shijshme,
Mishi i priftit mi tryezë,
Veç nga miku të mos ndahem,
Që në verë e munda shpejt,
Dhe m'u dha mënge në dimër.

## KËNGË CIGANËSH

Në mjergull e tym, në dëborë të trashë,
Në pyllin e egër dhe natën në dimër,
Dëgjova ulurimën e ujqve t'uritur,
Dëgjova cijatjen e bufit.
Gam gam, ham ham ham!
Gam gam, ho ho ho!
Gam gam, hu!

Dhe vrava një mace të zezë në gardh,
Ish macja e Anës që bënte magji;
Më ardhë atëhere, hop! shtatë lugetër,
Hop! hop! shtatë femra nga fshati!
Gam gam, ham ham ham!
Gam gam, ho ho ho!
Gam gam, hu!

I njihnja të gjitha, i njihnja fort mirë,
Ish Ana, Ursula, dhe Katja, dhe Liza,
Ish Barbeja, Eva, dhe Beta — të shtata;
Ato ulurinin rreth meje.
Gam gam, ham ham ham!
Gam gam, ho ho ho!
Gam gam, hu!

Ahere të shtatave u thirra me emër:
Çfar do ti, moj Anë, çfar do ti, moj Betë?
Ahere ato zunë të tunden, të shkunden.
Dh' u zhdukën dhe larg ulurinin.
Gam gam, ham ham ham!
Gam gam, ho ho ho!
Gam gam, hu!



# BALLADA

## MIGNON

**Të çuditëshmet përralla**
**Vjershëtori i bën të gjalla.**

E di ti vëndin plot limonj, e di,
Ku portokanjtë skuqin si flori? —
Nga qielli i kaltër era murmuron,
Dhe misri hesht, dhe bari mbretëron —
E di ti vallë?
Atje! Atje!
Atje, o i dashur, le të vemi ne!

E di shtëpinë tonë, atë shtëpi
Me dhoma, salla, shtylla plot stoli,
Çdo trup mermeri më vështron e pyet:
Ç'pësove ti, fatmjerë, kaqe vjet?
E di ti vallë?
Atje! Atje!
Atje, o mprojtës, le të vemi ne!

E di ti malin që gjithnjë gjëmon?
Në mjegull mushka vrragën e kërkon,
Në shtrofkë t'errët hyn e shfren dragoj.
Rrëzohet shkëmbi dhe mi të përroj —
E di ti vallë?
Atje! Atje!
Atje, o atë, le të vemi ne!

## KËNGËTORI

Kush po këndon në portë ashtu,
Ç'dëgjoj tek ura vallë?
Le të buçasë kënga shpejt
Përpara nesh në sallë!
Dhe mbreti tha, dhe pagu nget;
Dhe djali erdh, dhe mbreti flet:
Ma futni plakun brënda!

Ju përshëndes, o zotërinj,
Me damat anembanë!
Sa qiell i pastër! Yje plot!
Kush di se ç'emër kanë?
Në sallën tërë madhështi,
Pa mbylluni, ju syt' e mi,
S'ka kohë për mahnitje.

Dhe këngëtori syt'i mbyll,
Dhe plot me zjarr ja thirri;
Vështronin kavalerët drejt,
Dhe damat tek pëqiri.
Dhe mbreti këngën e pëlqen,
Dhe këngëtorin e shpërblen
Me një zinxhirkë t'artë.

Zinxhirkën mua mos ma jep,
E mbaj për kavalerë,
Vështrim'i tyre guximtar
I fut armikut tmerë.
E mbaj për kancelarin tënd,
Ta ketë barrë në çdo vënd
Veç barrëve të tjera.



Unë këndoj posi një zog,
Që rri këndon nër fletë;
Dhe kënga, që shpërthen vetiu,
Shpërblim është'ajo vetë;
Në mund të lutem: do të pi
Një kupë, derdhur në flori,
Me verën më të mirë.

Ay e ngreh, ay e piu:
O pije freskimtare!
O, lum shtëpia që dhuron,
Dhe kjo s'i rëndet fare!
Kujtomëni ndaj kini plot,
Dhe faliuni të madhit Zot,
Siç po ju falem unë.

## TRADHËTIA E MULLINARES

Që nga po vjen kaq shpejt ky miku.
Pa zbardhur mirë agimi ri?
Mos ish në kishëzën e pyllit,
Në kaq thëllin, për fetari?
E sheh i habitur lum'i qetë;
Po këmbëzbathur dalka sot?
Ç'përbuz të mirat e mëngjesit
Nër maja t'egra borëplot?

Ah, po! Shpëtoj nga shtrat'i ngrohtë,
Ku desh të tallej tinëzisht;
Sikur mos kish mi trun mantelin,
Do turpërohesh tmerësisht!
Ay kopuku e pat gënjyer,
Ja mori plaçkat shpejt e shpejt;
Dhe miku i gjorë doli jashtë,
Posi nj'Adam i xhveshur krejt.

Dhe pse u zvarrit nër këto vrraga,
Pse pas dy mollësh në mulli,
Që janë, po, si në parajsë,
Dhe në mulli, plot bukuri?
Këtë shaka më s'do ta bëjë,
Ng'ajo kasolle ay shpëtoj.
Dhe zu tashi po qahet jashtë
Me fjalë e britma lloj e lloj:

«S'më thesh vështrim'i saj i zjarrshëm
Asnjë kuptim për tradhëti!
Ajo marroseshe pas meje,
Po kish nër mënd mendim të zi!



Mi gjin' e saj mund t'ëndëronja,
Që zemra i rreh kaq mizorisht?
Gjith e vononte ajo Amorin,
Dh'ay na sillej ëmbëlsisht.

«Të ma shijojë dashurinë
Gjith natën që s'po kish mbarim!
Dhe pastaj mëmës t'i thërrasë,
Veç kur u bë për zbardhëllim!
U turrë brënda far' e fisi,
Një zhgan i tërë për hata;
Kish kushërinj, vështronin tetot,
Erdh një vëlla dhe një xhaxha.

«Bërtisnin egër e tërbonin,
Si bisha t'etura për shqim
Dhe lulet e së mjerës vajzë
I deshin prej kurrizit tim. —
Përse sulmoni si të çmëndur
Djaloshin e pafajshëm krejt?
Ay thesar, për t'u fituar,
Kërkon një vepërim të shpejt.

«E di Amori, pa vonesë,
T'i lozi lodrat me lezet!
Dhe në mulli, të tilla lule,
S'i le shtatëmbëdhjetë vjet. —
Ata m'i muar gjithë rrobet
Dhe deshin dhe mantelin tim.
Ç'pat nxënë ajo kasolle e ngushtë
Kaq lapanjozë e kaq mallkim!

«U hodha ahere si i tërbuar,
Q'askush të mos më ndalte dot.
E pashë përsëri të, poshtrën,
Dhe ah! ish prap' e bukur plot.
Ata, të trembur, u larguan;
Vazhduan pak me britm'e tmer,
Dhe duke sharë e uluritur,
Un' u shkëputa nga ky ferr.

«Do ndenjur larg pranisë suaj,
Ju vajza në qytet e fshat,
Dhe për t'i zveshur shërbëtorit,
Le t'enden zonjat në pallat.
Veç se, në qëngji ashtu të lira,
Dhe si ndjeni pak përgjegjësi,
Përdorni dashurorët tuaj,
Po tradhëtinë kurrsesi!»

Kështu këndon ay mes dimrit,
Kur asnjë fije s'gjelbëron:
Un'e përtall për këtë ngjarje,
Se ngjarjen mirë e meriton.
Kështu le ta pësojë i ligu,
Që dashurorëzën gënjen,
Dhe natën, në mulli t'Amorit,
T'Amorit fals, hyn e dëfren.



## PENDIMI I MULLINARES.

### Djaloshi

Largou, shtrigë esmere, shporru,
Nga kjo shtëpi e nderuar!
Apo do flokët të t'i shkul
Me duar!
Ç'këndon kështu me dhelpëri
Për shpirt besnik e dashuri?
Kush t'i dëgjon gënjeshtrat!

### Ciganka.

Këndoj për mall e mallëngjim,
Dhe për pendim të plotë;
Se vashëza me shpirt besnik
Derdh lotë.
Kanosj' e mëmës nuk e tremb,
Vëllaj i egër nuk i dhemb,
Sa i dhemb djaloshi i dashur.

### Djaloshi

Këndo për vjedhje e tradhëti,
Për vrasje e gjë të ligë;
Për çdo gënjeshtër të besoj,
Moj shtrigë.
Kur gjën' e vjedhur vetë e ndan,
Më keq se vjedhësi cigan,
Kjo mund që të besohet...

**Ciganka**

Ah ç'bëra! — Po tashi 'shtë von:
Përgjonja un' e shkreta:
Në dhomën time u fut ay...
Së fshehta...
Më rrinte zemra, po ç'dobi:
Oh! atë natë e dashuri
Mos t'ja tregonja mëmës!

**Djaloshi**

Dhe unë u futa, oh! dikur...
Ngadal... se s'm'u durua:
Moj shpirtkë! Më lejo të hy!
Të dua!
Po n'atë ças, në britmë e vaj,
M'u turrnë far' e fisi i saj... —
Më djeg dhe sot krahrori...

**Ciganka**

Sikur të vinte rasti prapë...
Ç'pësova dh'un' e ngrata!
E humba fatin më të madh.
Që pata...
Kam qënë e mitur, pa gjykim...
Sa keq me dashurorin tim,
Vëllaj i em u suall...

**Vjershëtori**

Dhe femr' e shkretë harbon n'oborr,
Në shatrivan, papritur;
Fytyrën mirë e paq e lan,
Dh'e ndritur
U bë fytyr' e saj sakaq,
Dhe mullinarja prapë u çfaq
Përpara djalosharit.



**Mullinarja**

Kam frikë prej zemrimit tënd,
O dashuror i lartë!
Prej thikës nuk kam frikë aspak!
Më qartë
Do të të flas për dashuri:
Nër këmbë të të vdes tashi,
Ose të rroj e lumtur!

**Djaloshi**

O dashuri, sa thellësisht
Më mbush me gas e jetë!
Ah, kush të zgjoj prej gjumit tënd
Të fshehtë?
Ti nuk vdes kurrë, o dashuri!
S'të vret e keqja tradhëti,
O jetë e perëndishme!

**Mullinarja**

Kur ti dhe sot më do kaq shumë,
Ashtu siç je betuar,
Asgjë më kot për ne të dy
S'ka shkuar
Pra merr të Dashurën tashi,
Merr virgjërorin trup të ri!
Çdo gjë tashi'sht'e jotja.

**Të dy**

Valo në qiell, o diell i bukur!
O yje fluturake!
Një dashuri m'u ndez në zemër
Plot flakë!
Sa kohë kroj buçet mi zall,
Ne do qëndrojmë plot me mall
Në shpirt të njëri tjetrit.

## SHTEGTARI DHE GJYSMATARJA [1]

**Ay**

Mund ti pra, moj gjysmatare e bukur,
Këtu poshtë, në këtë'hie bliri,
Ku po çlodhem si shtegtar një grimë,
Të ma shuash pak urinë e etjen.

**Ajo**

Urdhëro, se mjaft ti ke shtegtuar;
Me smetanë e bukë e pemë shumë.
Dhe me gjellët, ato më të thjeshtat,
Në burim do mundish të kënaqesh.

**Ay**

Po më duket, sikur të kam njohur,
Bukuroshe e kohës së kaluar!
Ka rastisur shpesh ndonjë përgjasje,
Veç se sot takoj çudinë vetë.

**Ajo**

Pa dyshim: vërejmë nër shtegtarë
Një mahnitje që kuptohet lehtë.
Se flokverdha ngjet me flokgështenjën,
Edhe njëra të tërheq si tjetra.

1) Gjysmatar = bujk që punon tokën e pronarit, të cilit i jep gjysmën e prodhimit.



**Ay**

Sot, vërtet, jo për të parën herë
Më tërhoqi kjo fytyrë e ëmbël!
Atëhere ish dielli mi diej
N'atë sallë festërisht të ndritur.

**Ajo**

Në ke qejf pra mund ta plotësojmë
Rastësisht shakanë e fantazisë:
Që nga beli i bij mëndafshi i purpurtë
Kur e pe ti vajzën për së pari.

**Ay**

Jo, vërtet, ti këtë gjë s'e shpike!
Mos ta thonë frymërat e larta?
Do t'i dish ti perlat dhe juvelat
Q'ajo krejt i shuan me vështrimin.

**Ajo**

Unë di një gjë që m'u besua:
Bukuroshja, plot me turp ta themi,
Dhe me shpresën se do shihi rishtas,
Nëpër erë ngriti mjaft kështjella.

**Ay**

Larg e larg më shtynë gjith furtunat!
Nder e ar kërkova pa pushuar!
Ç'lumtëri, sikur në fund të fundit
Të më dilte pamj'e ëndrës sime!

**Ajo**

Jo një pamje, po vërtet të doli
Bij' e lart e fisit të përbuzur:
Sot në fermën, q'u pat neveritur,
Rron plot gas me të vëllanë, Helena.

**Ay**

Këto pllaja të mërekullishme
Si i lëshoi pronari i shkretë i tyre?
Fusha t'arta... pemë dhe livadhe..
Kronj të pastër... qiell i magjishmë..

**Ajo**

Në mërgim ay u pat arratisur!
Me përpjekje, ne fituam shumë;
Dhe, siç thonë, ay në pastë vdekur,
Do t'ja blejmë tërë trashëgimin.

**Ay**

Blerkë e mirë, bukuroshja ime!
Prej pronarit kam dëgjuar kushtet;
Porse çmimi s'ësht' aspak i vogël,
Sepse fjal'e fundit ësht' Helena!

**Ajo**

S'na bashkon as fati, as fisi i zgjedhur!
Këtë rrugë mori dashuria
Ja ku vjen vëllaj i em i bëshmë:
Ç'do të thesh ay, po të dëgjonte?



## PERËNDIA DHE BAJADERA

Mahadeva, Zot i dherit,
Për së gjashti zbret përdhe,
Vjen pas gazit edhe vrerit,
Që të bëhet posi ne.
Mirë i vjen këtu të rrojë,
I merr punërat lirisht.
Njerëzit, që t'i gjykojë,
Do t'i shohë njerëzisht.

Dhe kur si shtegtar në qytet pat vështruar,
Të fortët përgjuar, të vegjlit dëgjuar,
Ndaj mbrëmjes i le, shkon më tej qetësisht.

Dhe si jashtë ay pat dalë,
Nër shtëpitë e fundit, sheh
Një të bukur të përdalë,
Faqe lyer për harè.
— «Falem, vashë!» — «Lum për nderë!
ja, po vi me ty tashi».
— «Dhe kush je ti?» — Bajaderë,
Kjo shtëpi, për dashuri».

Dh'ajo zë një valle e godet me çepare,
Dhe dridhet, përdridhet në qark ledhatare,
Dhe ulet, përkulet me lule drejt ti.

E tërheq në prag nga pakë,
Në shtëpizë e shpje me nxit.
— «Bukurosh i huaj, flakë
Ty kasollen do ta ndrit.

Në je lodhur, të çlodh unë,
Këmbëve t'iu sjell shërim.
Do kënaqesh me çdo punë,
Qoftë prëhje apo dëfrim».

Ajo ia leson dhëmkat false me duar;
I Qiellshmi qesh; ay sheh i gëzuar,
Një zemër njeriu n'atë prishje e shkretim.

Do shërbime skllavërore;
Po m'e qeshur ajo flet,
Bëhen lajkat vajzërore
Ca nga ca duf i vërtet.
Kështu lul'e lulëzuar
Pjek dhe pemën shpejt a von;
Për një zemër të kushtuar,
Dashuria nuk vonon.

Ay, sa më keq në provim për ta sjellë,
Si njohës që di çdo të lartë e të fellë,
Gëzim e të vojtur asaj i shkakton.

Dh'e puth fort, ashtu të lyer,
Dh'ajo djeg për dashuri,
Dhe rri vasha mëndrrëmbyer,
Dhe së pari qan tashi;
Dhe nër këmbë i bje e mbaruar,
Jo për epsh, as për fitim,
Ah, të shkathtat këmbë e duar,
Ato s'bëjnë dot shërbim.

Kështu për në shtrat, për në festën gazmore,
I endet pëlhurës së ëmbl' errësore,
Nga orët e natës i hijshmi mbulim.

Von si i fjet ajo nër duar,
Shpejt si zgjohet përsëri;
Mikn[2] e shumëdashuruar
E gjen vdekur përmi gji.



Britma sakaqher'u ndjenë,
Bje mi të, po s'e zgjon dot.
Dhe të grop' e zjarrit shpjenë
Trupn'e mpirë që më s'lot.

Me këngët e vdekjes dëgjon priftërinë,
Vrapon e gulçon e përshkon njerëzinë.
— «Kush je ti? Ç'të shtyn për në varr kaq me bot?»

Ndaj qivurit u rrëxua,
Britm'e saj buçet me zjarr:
— «Burrin tim e mjera dua!
Dh'e kërkoj këtu në varr.
Të ma shkrijë hiri i shkretë
Atë shtat si perëndi?
Imi! ish imi ay përjetë!
Ah, o natë, o ëmbëlsi!»

Këndon priftërija: — «Ne pleqt'e motuar
I shpiemë si mpihen e thahen vonuar,
Në shpjemë rininë, kur edhe s'e di.

Dëgjo priftërit e ndjerë:
Ky pra burri yt nuk qe.
Se ti rron si bajaderë,
Dhe detyrë aspak nuk ke.
Vetëm trupin e ndjek hija
Në të vdekjes mbretëri;
Burrin vetëm shoq'e tija:
Si detyrë e si lavdi.

Buçit, o trumbetë, për vajë të shenjtë!
O merrni, ju zotër! Stolinë të shtrenjtë,
O merrni me flakët djaloshin në gji!»

Kështu kori, pa mëshirë,
Vrer'e zemërës ja shton
Dhe ajo me kraha shtrirë
Për në vdekj'e zjarr sulmon.
Porse lart, prej asaj flake,
Ngrihet djali-përëndi,
Dhe nër krahat fluturake
Mban të dashurën e ti.

Me gas hyjëritë pendimin e ndjejnë:
Fëmijën që humb, të pavdekshmit e ngrejnë
Me kraha të zjarrshme në qiell e lavdi.



# SONET

## SUPRIZË E FUQISHME

Shpërthen me vrull që lart përmi greminë,
Dhe shkon drejt detit lum'i shkumëzuar;
E kqyrin brigjet duke u pasqyruar,
Ay s'ndalon e zbret nëpër luginë.

Po në një çast demonërisht rrëxohet —
E ndjekin mal e pyll me votrqneta —
Dhe mbushet Oreas me gëzim jete
Duk' e shtërnguar lumin të ngushtohet.

Shkon vala praptas, ngrihet që nga shtrati,
Dh'e fryrë e egër gumëzhin përpjetë;
Iu ndal drejtimi e s'vete dot tek ati.

Ajo bër. pellg, bën një liqer të qetë;
Ia ndriti fundin yjet plot hare
Ndaj rreh me vrull mi shkëmb një jetë e re.

# KANTATË

## JOHANNA SEBUS

**(Për kujtimin e shtatëmbëdhjetë vjeçares së bukur dhe shpirtmirë nga fshati Brienen, e cila u mbyt më 13 janar 1809 duke shpëtuar të tjerët gjatë akujve të Rinit dhe këputjes së digës së Cleverham-it).**

Këputet diga, fusha këlthet,
Vërshojnë ujrat, vala buçet.
«Të marr, moj nënë, unë më krah,
S'ësht' edhe fellë, kalohet më va». —
«Kujtome dhe mua, me tre fëmi!
Që bashkëbanojmë në një shtëpi!
Se jam e dobët! — Ti shkon, po na le!» —
Ajo nëpër ujë nënën e shpje.
«Shpejt, shpejt mi kodër! bëni durim;
Vi prapë tek ju, dhe do gjeni shpëtim.
Pa ujë 'sht' akoma çuka për bri,
Ma merrni dhe mua atje këtë dhi!»

Dërmohet diga, fusha këlthet.
Vërsulen ujrat, vala buçet.
Në vënd të sigurtë ajo nënën e qit,
Suzanka e bukur kthehet me nxit.
«Ku vete? Ku vete? Uji u fry;
Përmbytje sa mund të shikosh me sy
T'i çash thellësirat ti do me guxim!» —
«Po duhet, po duhet të gjejnë shpëtim!»
Dhe diga zhduket, valoma këlthet,
Një det i tërë zjen e buçet.
Suzanka e bukur bën hap me bot,
Gjith ujrat përqark s'e kthejnë dot,
Te çuka dhe fqinja ajo erdh me guxim:
Për fqinjë e fëmijë asnjë fitim!



Fundet gjer në brirë e shkreta dhi,
Humbasin të gjithë në vir të zi!
Suzanka e bukur drejt po qëndron:
Ah, jetën fisnike kush ja shpëton?
Suzanka e bukur që ndrin si yll.
Po çdo shpëtimtari udha iu mbyll.
Dhe rreth për qark veç ujë e det
Dhe asnjë lundër për të nuk pyet.
Në qiell dhe nj'herë ajo sytë i shtiu,
Me përkëdhelje uji e përpiu.

S'ka digë, s'ka fushë... Veç ku e ku
Tregon për vëndin një pirg, një dru...
Përmbytj' e madhe mbulon çdo gjë,
Po shpirt 'i Suzankës ndrit mi të.
Ze ulet uji, del toka pastaj,
Suzankën e bukur e qajnë me vaj, —
Dhe ay q'atë s'e kujton, s'e këndon,
Ay midis njerëzve s'ka ç'i kërkon.

# POEZI TË NDRYSHME

## KËNGA E VAJTIMIT TË GRUAS FISNIKE TË ASAN AGAJT

*(Nga morlakishtja)*

Çfar' po zbardh ashtu tek pylli i gjelbër?
Mos dëbora a mos po zbardhin mjellmat?
T'ish dëbora, do të kishte shkrirë;
T'ishin mjellmat, kishin fluturuar.

S'ësht' aspak dëborë e s'janë mjellma,
Ndritin çadrat e Asan Agait.
Ay brenda dirgjet i plagosur;
Nën' e motër vijn' e vizitojnë,
Bashkëshort' e turpshme po vonohet.

Po kur plaga iu përmirësua,
Fialë ai i dërgoi besnikes grua:
«N'oborr tim aspak të mos më presish,
As n'Oborr dhe as nëpër të mijtë».

Kur i erdh kjo fjalë e rëndë gruas,
U ngurros besnikja plot me dhëmbje,
Ndjen tek porta si trakojnë kuajt,
Thotë se vjen burri i vet Asani,
Rend sakaq në pirg që t'hidhet poshtë.
Plot me angth e ndjekin dy të bijat,
Dhe i thërresin duke derdhur lotë:
«S'janë hamshorë t'atit tonë Asanit,
Erdh vëllaj i yt Pintoroviçi!»



Kthehet bashkëshort' e pikëlluar,
E pushton nër kraha të vëllanë:
«Shih, vëlla, sa turp për motrën tënde!
Të më lerë me pesë fëmijë!»

Hesht vëllaj dhe nxjerr pastaj nga xhepi,
Brenda në mëndafsh të kuq palavur,
Shkresë-ndarjen krejt të përfunduar,
Që të kthehet në shtëpi të s'ëmës,
Të martohet me një burrë tjetër.

Kur pa gruaja të zezën shkresë,
Puthi të dy djemt' e saj në ballë,
Puthi të dy bijëzat në faqe,
Po prej foshnjës, ah! në djep të lidhur
S'mund të ndahet dot nga dhëmbj' e madhe!
Shpejt e xhvat vëllaj i papërmbajtur,
Shpejt e hyp në kalin e harbuar,
Dhe kështu me gruan e tronditur
Rend për tek konaku i t'et i lartë.

Pakëz kohë shkoj, as shtatë ditë;
Pakëz kohë ish mjaft: dhe shumë zotër
Gruan tonë të pangushëlluar
E kërkuan shpesh për bashkëshorte:
Më fisniku — Kadiu i Imoskit.

Të vëllajt me lot i lutet murga:
«Më dëgjo, vëlla, për kokën tënde,
Mos më jep më n'asnjeri për grua,
Që fëmijëthit e mi të dashur,
Kur t'i shoh, të mos më plasi zemra!»

S'e dëgjon vëllaj seç thotë asfare,
Me kadinë e madh do ta martojë.
Por e mira me gjith shpirt i lutet:
«O vëlla, dërgo pakmos një fletë
Tek kadiu i madh me këto fjalë:
«Plot me nder të përshëndet vejusha,
Dhe me këtë fletë po të lutet,

Që, me shoqëronjësit e lartë,
Një duvak të madh ti të më sjellish,
Të mbulisem ndaj shtëpis' s'Asanit,
Mos t'i shoh jetimëthit e dashur.»

Sapo e pa kadiu pra këtë letër,
Mblodhi shoqëronjësit të gjithë,
Dhe u gatit për udhë për tek nusja
Dhe duvakun q'ajo kish kërkuar.
Tek princesha arritën të gëzuar,
Me princeshën duall të gëzuar.
Kur u nqasën ndaj shtëpis' s'Asanit,
Panë mëmën q'atje lart fëmija;
Thirrën: «Haj në sallën tënde prapë!

Të hash darkën bashkë me fëmijët!»
Plot trishtim i ndjeu fëmijët mëma.
Kthehet për nga princ' i madh me fjalët:
«Ndal, o ndal hamshorë e shoqëronjës,
Ndali tek të dashurit në portë,
Që t'u jap të vegjëlve dhurata».

Dhe tek port' e dashur ata ndalnë,
Dhe fëmijve ajo dhurata u fali;
Djemkave, këpucë me qindisme,
Çupkave, të mveshura plot hie,
Foshnjëzës në djep, pa fare ndihmë,
Një fustankë për kohën e ardhme.

Këto i pa mënjanë Asan Agai,
Iu shkëput fëmijëve të dashur:
«Hajni, o fëmijëthit e shkretë!
Gjiri i mëmës suaj ësht' i hekurt,
Ësht' i mbyllur, nuk ndjen dot mëshirë».

Kur këto i dëgjoj ah! mëm' e dhemshur,
Sakaqherë u shëmb përposh mi tokë
Dhe nga gjiri i angthshëm u nda shpirti,
Kur ajo fëmijët i pa t'ikin.



## KËNGA E MUHAMETIT

Shikoni krorin shkëmbor,
Gëzim-kulluar,
Posi një vështrim i yllshëm;
Që përmi re
Ushqyen rininë e tij
Frymërat e mira
Midis shkëmbinjsh nër gëmusha.

Rini-freskët,
Ay vallzon nga reja
Përposh mi shkëmbinjt' e mermertë,
Brohorin përsëri
Drejt qiellit.

Midis grykave të larta
Turret pas strallave larushe,
Dhe me hap shpejtonjës
Kroret — vëllezër të tij
I rrëmben me vete.

Atje përposh në luginë
Dalin lule nënë këmbët e tij,
Dhe livadhi
Jeton prej frymës së tij.

Po atë s'e ndalon dot lugina me hie,
As lulet
Që i pushtojnë gjunjët,
Duke e përkëdhelur me vështrim dashurie:
Drejt fushës depërton fryma e tij,
E gjarpëruar.
Përrenj i ngjiten
Shoqërisht. Tashi ay shkel
Në fushë duke shkëlqyer si argjëndi,
Dhe fusha shkëlqen me të,

Dhe lumenjt' e fushës
Dhe përrenjt' e malit
I brohorasin dhe thërresin: Vëlla!
Vëlla, merri me vete vëllezërit,
Me vete për tek Ati i yt plak,
Për tek Oqeani i përjetshëm,
Që na pret neve
Me krahat hapur,
Që, ah! më të kot hapen,
Për të pushtuar ata që e dëshirojnë,
Sepse neve na bren në shkretëtirën e thatë
Shuri lakmimtar; dielli atje lart
Thith gjakun tonë; një kodër
Na ndalon për në liqer! Vëlla,
Merri me vete vëllezërit prej fushës,
Merri me vete vëllezërit prej maleve
Për tek Ati i yt!

Ejani të gjithë! —
Dhe tashi ay fryhet
Më madhështor; një gjeneratë e tërë
E ngroh princin në lartësi!
Dhe në triumfin vërshonjës
Ay u jep vëndeve emra, qytete
Ngrihen nënë këmbët e tij;

I papërmbajtur ay buçet më tej.
I le pas majat e përflakura të pirgjeve,
Shtëpira mermeri, një krijim
I plotësisë së Tij.

Shtëpira cedri mban Atlasi
Mi supet vigane; duke ushëtuar
Valojnë përsipër kokës së tij
Mijra flamure nëpër erë;
Dëshmitarë të madhështisë së tij.

Dhe kështu ay ia shpije vëllezërit e tij,
Thesarët e tij, fëmijët e tij
Atit pritës,
Me buçim gazmor në zemër.



## KËNGA E FRYMËRAVE PËRMI UJRA

Shpirt' i njeriut
Përngjet me ujin:
Nga qielli ky vjen,
Në qiell ngrihet prapë,
Dhe rishtas poshtë
Mbi tokë kthehet,
Ndërron përjetë.

Kur rrjedh nga i larti
Ledh shkëmbor
I pastri curril,
Bje ëmbël si pluhur
Nër valë avujsh
Mbi shkëmbin tullac,
Dhe i pritur lehtë,
Valon gjarpëruar
Me zhurmë të heshtur
Drejt fundit në hon.

Shkëmbenj kur i ngrihen
Përkundër derdhjes,
Nxjerr shkumë ay hidhur
Dhe zbret shkallë-shkallë
Drejt honit të madh.

Mbi shtrat të nderë
Shket nër lëndina ngadal,
Dhe ja në liqerin e fjetur
Shohin fytyrën
Yjet të gjithë.

Era ësht' i valës
I dashur i ëmbël;
Era i përzen fund e krejt
Valët shkumore.

Shpirt i njeriut,
Si ngjet ti me ujin!
Fat i njeriut,
Si ngjet ti me erën!



## PERËNDESHA IME

Cilës së pavdekshme
I duhet dhënë çmimi më i lartë?
Me asnjeri nuk hahen,
Po unë ia jap
Përjetësisht së lëvizurshmes,
Gjithnjë së resë,
Së çuditëshmes bijë të Jupiterit,
Fëmijës së tij të pëqirit,
Fantazisë.
Sepse asaj Ay
ia dha
Të gjitha kapricat,
Të cilat vetëm
Për vetëhen e tij i mban,
Dhe shijon gëzimet e tija
Me të trerosurën.

Ajo mund, trëndafil-kurorëzuar,
Me degën e zëmbakut
Të shkelë mi luginat luleplota,
T'u japë urdhër zogjve të verës,
Dhe vesën ushqimlehtë
Me buzë bletësh
Ta thithi prej luleve;

Ose mund
Me flokë valonjës
Dhe vështrim të mvrenjtur
Të buçasë në furtunë
Rreth shkëmbinjve
Dhe me njëmijë gjyra,

Si mëngjesi dhe mbrëmja,
Duke ndryshuar gjithnjë
Posi vështrime hëne,
T'u ndritë të vdekshëmve.
Le ta lavdërojmë të gjithë
Atin
Të lashtin, të lartin,
Që një të tillë bashkëshorte
Të bukur dhe të pavdirur
T'ia falë njeriut të vdekshëm
Si shoqe!

Sepse vetëm për nesh
Ay atë e pat lidhur
Me lidhëse qiellore,
Dhe asaj i pat urdhëruar
Që në gëzim dhe mjerime
Si bashkëshorte besnike
Të mos mënjanohet.

Gjithë të-tjerat
Gjenerata të mjera
Të tokës së gjallë
Fëmijë-plote
Enden dhe dëfrejnë
Me shijim të errët
Dhe vojtje të turbull
Të së kufizuarës
Jetë momentare,
Të përkulura nga zgjedha
E nevojës.

Po neve
Ay, gëzohuni! na pat falur
Bijën e tij shumë të shkathët,
Të përkëdhelur!
Takoheni me ëmbëlsi,
Posi një dashurore!
Lernia asaj detyrën e lartë
Të grave në shtëpi!



Dhe vjehra plakë
Dituri
Shpirtkën delikate të mos e fyejë!

Po un' e njoh motrën e saj,
Më të madhen, në të përmbajturën,
Mikeshën time të qetë:
O, vetëm me dritën e jetës
Le të ndahet prej meje ajo,
Fisnikja shtytëse,
Ngushëllonjëse: shpresa!

## PROMETHEU

Mbuloe qiellin tënd, o Zeus,
Me avull resh
Dhe bëj, posi djaloshi.
Që këputet kokat e cinxujve,
Ushtërimet e tua mi pisha dhe maja mali,
Po ti mua je i detyruar tokën time
Të ma lesh,
Dhe kasollen time, që nuk e ndërtove ti,
Dhe vatrën time,
Për prushin e së cilës
Më ke zili.

Unë nuk di gjë më të mjeruar
Nënë diell, përveç jush, o Zotër!
Ju varfërisht ushqeni
Me therrorira
Dhe frymë lutjesh
Madhërinë tuaj,
Dhe do të vdisnit urie
Sikur mos kish të lutur dhe lypës
Budallenj plot me shpresë.

Kur unë isha një çunak;
Dhe s'dinja si e qysh t'ja bëj,
Shpinja syrin tim të arratisur
Drejt diellit, sikur atje lart të kish qënë
Ndonjë vesh që të ma dëgjojë ankimin tim,
Ndonjë zemër, si kjo imja,
Që të mëshirohet për shpresëhumburin.



Kush më ndihmoj
Kundër mburrjes së Titanëve?
Kush më shpëtoj prej vdekjes,
Prej skllavërisë!
Nuk e përmbushe çdo gjë ti vetë,
Moj Zemër, shenjtërisht e përvëluar?
Dhe ti përvëloheshe, rinisht dhe shpirtmirë,
Shpirtgënjyer, në falënderim shpëtimi
Për të Fjeturin atje lart.

Unë të të falënderoj ty? Përse?
Ke lehtësuar ti ndonjëherë dhëmbjet
E të shumërënduarit?
Ke tharë ti ndonjëherë lotët
E të angthmunduarit?
Nuk më farkëtoj mua dhe më bëri burrë
E plotfuqishmja kohë
Dhe fati i përjetshëm,
Zotërit e mij dhe të tu?

Kujtonje ti vallë,
Se unë jetën do ta urrenja
Do të iknja në shkretëtira,
Sepse jo të gjitha
Ëndrat e lulëzuara u përmbushnë?

Këtu rri unë, krijoj njerëz
Pas fytyrës sime,
Një brez, që të jetë njëjt me mua,
Të vuajë, të qajë,
Të shijojë dhe të gëzohet,
Dhe ty mos të ta vari veshin, si unë!
Si unë!

## GANIMEDI

Si më flakëron ti mua rreth e për qark
Në shkëlqimin mëngjesor,
Parëverë, moj e dashur!
Me dëfrim të mijëfishtë dashurie
Sulmon në zemrën time
Ndjenja e shenjtë
E ngrohtësirës sate të përjetëshme,
Bukuri e pakufizuar!

Sa desha të të pushtoj
Me këto krahë!
Ah, në gjirin tënd
Unë jam shtrirë, lëngoj,
Dhe lulet e tua, bari yt
Sulmojnë zemrën time.
Ti freskon përvëlonjësen
Etje të gjirit tim,
O erë e ëmbël e mëngjesit!
Thërret bilbili
Pas meje nga lugina mjergullore.
Do vi, po vi!
Për ku? Ah, për ku?

Lart! Për lart është përpjekja.
Valojnë retë
Tatëpjetë, retë
I shtrohen mallplotës dashuri,
Mua! Mua!
Në pëqirin tuaj
Për tatëpjet!
Duke pushtuar i pushtuar!
Drejt lartësirës në gjirin tënd,
At, tërëdashuronjës!



## KUFI TË NJERËZIMIT

Kur i stërlashti
At i shenjtë
Me dorë të lirë
Prej resh gjëmimtare
Rrufe bekimi
Lëshon përmi dhe,
Ja puth unë fundin
Rrobes së tij,
Me drithëm fëmije
Në gjirin tim.

Sepse me Zotërit
S'bën që të matet
Kurrë njeriu.
N'u ngritt' ay lart
Dh' atje në prektë
Me kokën, yjet,
Askund s'i mbështetet
Këmb' e pasigurt,
Dhe retë dhe erërat
Lozin me të;

Po dhe në qëndroftë,
Me koskën e fortë,
Mbi dherin e ngjizur
Si shkëmb i përjetshëm;
S'arrin ay kurrë
As krahasimin
Veç me një dushk
Ose nj' hardhi.

Ç'far i dallon
Zotrit nga njerzit?
Se shumë vula
Ndaj tyre enden,
Një rrjedhj' e përjetshme:
Në vala na ngreh,
Ne vala na thith,
Pastaj fundasim.

Një rreth i vogël
Rrethon jetën tonë.
Dhe shumë breza
Radhiten përherë
Në vargun pafund
Të qënies së tyre.



## E PERËNDISHMJA

Fisnik le të jetë njeriu,
Ndihmëtar dhe i mirë!
Se vetëm kjo
E bën të dalluar
Nga gjithë qëniet
Që ne njohim.

Lavdi të panjohurave
Qënie të larta,
Që ne i marrim me mënd!
Atyre t'u ngjajë njeriu,
Shëmbëlla e tij të na mësojë
Që ne ato t'i besojmë.

Erë e lumenj,
Gjëmim e breshër
Buçasin udhës së tyre
Dhe kapin,
Në ikje të shpeitë,
Njërin dhe tjetrin.

Kështu dhe fati,
Verbërisht, midis turmës,
Kap kur leshdredhurën
Pafajësi të dialoshit,
Kur edhe kokën
Tullgë fajtare.

Pas ligjesh të përjetëshme,
Të forta, të mëdha
Ne duhet, që të gjithë,
Të përmbushim rrethin
E qënies sonë.

Vetëm njeriu
Bën të pamundurën;
Ay dallon,
Zgjeth edhe ndreq;
Ay i jep grilës
Qëndrim të vazhduar;

Veç ay mund
Të mirin ta shpërblejë,
Të ligun ta dënojë,
Të shërojë dhe shpëtojë,
Çdo arratisje, shpërndarje
Me dobi ta bashkojë.

Dhe ne i adhurojmë
Të pavdekurshmit,
Sikur të ishin njerëz,
Sikur të bënin, në madhësi,
Atë që m'i miri, në vogëlsi,
Bën ose do deshte.

Njeriu fisnik
Le të jetë ndihmëtar dhe i mirë!
I palodhur le të bëjë
Të dobishmen, të drejtën,
Të jetë për ne një shëmbëll
I atyre qënieve që i marrim me mënd.



## PLAKU I LILIT

Nuk ka ndonjë menazheri,
Si kjo e Lilit time plot larmi!
Me kafshët më t'habitëshme në botë,
Që, si i gjen, as vetë s'mund të thotë.
Oho, si hidhen kafshët, dh'harbojnë dhe trokojnë,
Me kraha të shkurtuara si përparojnë,
Të shkretët princër, gjithë të bashkuar,
Me dhëmbje dashurie që kurrë s'ka të shuar.
Si quhej Zëra? — Lili? — Mos pyetni kot së koti!
Në mos e dini, ju ka dashur Zoti.

Se ç'zhurmë dhe guakësim,
Ahere kur ajo qëndron në derë!
Sepetkën me ushqim e mban nër duar kurdoherë!
Seç kakarisje dhe cijim!
Gjith drurët, gjith gëmushat sikur gjallërohen
Dhe turma të panumurta i lëshohen
Nër këmbë; po dhe pishqet në basin
Me kokat jashtë kqyrin papushuar.
Ajo u shpëndan ushqim me duar,
Me një vështrim — që Zotërit i ve n'habitje,
Dhe si jo kafshët. Dhe pastaj dëgjohet një çëkitje,
Një thithje, një goditje e përsëritur.
Ato mi njërajatrën bëjnë sulm papritur,
Lëshohen, shtyhen dhe shtrëngohen,
Qëllohen, trëmben dhe kafshohen
Dhe gjithë kjo gjë, për një kothere bukë,
Që, e thatë, nga ato duar t'hijshme ka një shije

Posi nj'ushqim i ëmbël ambrozije.
Po dhe vështrimi, toni,
Kur zëri i saj thërret: Pipi! Pipi!
Do ta lëshonte dhe shqiponjën e Zeusit nga froni;
Çifti i pëllumbave të bukur të Venuses mitare,
Bile palloj me sjelljen aq krenare
Betohen se do vinin menjëherë
Kur atë ton që larg ta kishin ndjerë.
Ajo kështu, nga pylli që nxin në terr e natë,
Gënjeu nj'arì që nuk kish edukatë,
Pas urdhërit të saj me lehtësi,
E pruri midis kompanis së zbutur krejt për bukuri,
Dh'e zbuti me të tjerët lehtë,
Gjer në një farë pike — kjo kuptohet vetë.
E bukur dhe shpirtmirë
Dukej ajo. Me gjith dëshirë
Unë do derdhja gjakun tim, për t'ja vaditur lulet.

«Ju thatë **unë**? Cili? Si?»
Pra mirë, Zotërinj, ja: **Unë** jam ay ari,
I kapur në një fustë rrjeti,
Me një pe të mëndafshtë nër këmbët e saj un' i shkreti.
Po si pat ngjarë, si, kjo punë?
Një herë tjetër kam për t'ju treguar;
Se sot jam tepër i zemruar.

Haha! Kur rri në qoshe,
Dhe ndjej që larg kërrokërimat
Dhe fluturimat, fërfëllimat,
Papritur unë kthehem
Dhe hungëri dhe nxehem,
Dhe turrem prapa shpejt një copë herë,
Shtje sytë rrotull si i trerë
Dhe hungëri
Dhe rend një copë herë përsëri, si për çudi.

Pastaj fillon sakaq tërbimi,
Një frymë e plotfuqishme turfullon nga shfrimi,
Natyra bëhet prush.
Ç'far, o i lojtur mëndsh, o ljepurush!



Pipi! O ketërr, për të thyer arra!
Ja, unë ngreh përpjetë xverkun tim,
I pamësuar që të bëj shërbim.

Çdo pemë kryelartë tallet
Me mua! Unë ik nga Boulingreeni i ri,
Nga bari i prerë rrafsh për bukuri;
Më tall dhe bushi posi një të çmëndur,
Un' ik e futem në gëmushën më të dëndur,
Të kapërxej, çdo gardh e çdo rrethim,
Dhe të kërcej mi pllashta me tërbim.
Po s'mund të kacavirem kurrsesi,
Më shtyp si plumbi një magji,
Magjia më kap përsëri,
Mundohem dhe përpiqem, dhe kur më s'kam fuqi,
Rri shtrirë ndaj kaskadash artificiale
Dhe qaj dhe psherëti, përdridhem mengadale,
Dhe ah! rënkimin ma dëgjojnë
Veç Oreada porcelani që s'kuptojnë.

Papritmas, ah, në gjith këtë mënxyrë
Një ndjenjë lumtërie më preku çdo gjymtyrë!
Këndon ajo, këndon ajo në pjergullën e saj!
Dhe përsëri un' e dëgjoj me t'ëmblin zë, me t'ëmblin zë,
Gjith era ësht' e ngrohtë, me lulëzime lloj e lloj.
Ajo, ah, po këndon, që unë ta dëgjoj!
Përçaj çdo gjë, i shkel gëmushat anembanë,
Largohet bushi, drurët përhapen shpejt mënjanë,
Dh' asaj, kështu — nër këmbë i shtrihet kafsha.
Ajo, i shtje sytë: «Një përbindsh! një ruskudan!
Posi nj'ari i butë, i shtruar,
Posi një qen, i egër e i druar,
E leshaman e trashaman e xhungaman».
Ajo e përkëdhel me këmbën mi kurriz:
Ay beson se gjindet mu në paradis.
Të shtatë shqisat e ngacmojnë lehtë!
Ajo ka pamjen sikur ësht' e qetë.
Këpucët, shallat un' i puth tashi,
Aq urtë e butë, aq sa mund nj'ari;
Pa u ndjerë ngrihem, hidhem më të fshehtë

Mi gju të saj. — Ajo do vetë
Dhe më lejon, më gudulis nër veshë
Dhe më pret syve si një trimëreshë;
Unë rilind nga ky dëfrim;
Pastaj ajo kërkon, me tallje e dëshërim:
**Allons tout doux! eh la menotte!**
**Et faites Serviteur,**
**Comme un joli Seigneur;**
Ajo vazhdon kështu dhe lot e qesh gjithnjë;
Shpreson... Ky budalla i gënjyer shpesh;
Dhe kur e kundërshton për ndonjë gjë,
Ajo ja pret si shkurt e shan e qesh.
Po dhe në pastë ndonjë shishkë me balsam
(Që s'ja shkon dot as mjalta më me nam)
Dhe me të cilin, zbutur prej dashurie dhe besnikërie,
Përbindëshit të saj ajo mi buzën e zhuritur
I hedh me majë gishti një pikë kurreshtie
Dhe prapë ik, dhe mua më le të neveritur,
Dhe unë ahere, ashtu i lëshuar,
Me mëndjen krejt pas saj e ndjek gjithnjë
Duk' e kërkuar, duke fërgëlluar... ah 'ik përsëri pa të —
Ajo e le të shkretin të endet në vetmi,
S'e prek gëzim' i ti, s'e prek as dhëmbj' e ti —
Ha! dhe më le nganj' herë ndaj derës gjysmë t'hapur të
[qëndroj,
Më tall e më sheh vëngër, në dua që të shkoj.

Dhe unë! — O Zotër, që në dorën tuaj
E kini të mbarojë kjo lodr' e errët ku po vuaj,
Se si ju falem nderit, që të më linit në liri!
Po ju këtu përdhe nuk më dërgoni ndihmë kurrsesi,
Kështu jo fare kot un' i ndeh krahat!
Bëj be dh' e ndjej: Akoma kam fuqi.



## NEVOJË DASHURIE

Kush më ndjen? Ah, kujt t'ja them të keqen?
Kush do ndjente, do ma qante hallin.
Ah, se buza, që kaq gas të ëmbël
Pat shijuar dhe pat dhënë vetë,
Ësht' e plasur dhe ka shumë dhëmbje.
Oh' ajo s'është kurrsesi e plagosur
Se m'u sul fort egër dashuria
Dh' ëmbël më kafshoj, q'ajo (për mikun
Duke u siguruar) ta shijojë:
Jo — po buz' e freskët u pat çarë
Se tashi mi brymë e ngricë erat
Më përplasen keq, pa dashur.
Dhe tashi fisniku lëng i rrushit,
Me gjith lëng të bletës pranë zjarrit
Duhet, heshtur, të më lehtësojë.
Ah, ç'dobi, kur s'jep aty një pikëz
Dashuria nga balsami i saj?

## MALL

O vashë e ëmbël fort,
Ti me ata flok të zes,
Që vete në dritare,
Që ndalesh në ballkon!
Po ndalesh ti më kot.
O, t'ishe aty për mua,
Ta losnje, vashë, rezen,
Se sa do t'isha i lumtur!
Sa shpejt do turrsha lart!



## MUSAGETAT

Shpesh, nër netë dimërore,
Thirra Muzat hirmëdhaja:
S'çel asnjë mëngjes i ndritur,
Asnjë ditë s'vjen të zbardhë,
Veç ma sillni kur më duhet
Dritën e së mirës llambë,
Që, për Aurorë e Febus,
Të ma ngjallë zellin tim!
Po në gjumë ato më lanë,
Gjumë t'errët e të rëndë,
Dhe, me çdo mëngjes të vonshëm,
Shkuan ditët më të kot.

Erdhi parëver e bukur
Dhe bilbilave ju thashë:
«O bilbila, ligjëroni
Shpejt para dritares sime,
Zgjomëni nga gjumi i rëndë,
Ku po digjet djaloshari».
Po të lartët këngëtarë
Ja filluan në dritare:
Melodi'e ëmbl'e tyre
Shpirtin tim e mbajti zgjuar,
Ngjallmë një dëshirë t'ëmbël
Prej krahrorit të rindezur.
Dhe kështu pra vate nata
Dhe më gjet në gjumë Aurora,
Dielli thuaj se s'më zgjoj.

Më në fund u duk dhe vera
Dhe që në mëngjes të parë
Vjen më shkund nga gjumi i ëmbël

Miz'e papërtuar fare.
Kthehet rishmi pa mëshirë,
Ndonse djali i gjysmë-zgjuar
E përzen e s'ka durim,
Ndiell motrat e paturpshme,
Dhe kështu nër syt' e mi
Gjumi i ëmbël më s'qëndron.
Unë sulem shpejt nga shtrati,
Kërkoj Muzat dashurore,
I gjej pyjeve me lisa,
Ëmbël duke më pranuar:
Të mërziturat insekta
Më dhurojnë grima t'arta.
Merrni pra, moj të mërzitshme —
Musageta të vërteta —
Lavdurim prej vjershëtorit.



## VIZITA

Dashuroren desha ta shoh tinës,
Ish e mbyllur der'e shtrenjtë e saj.
Po në xhep, në xhep un'e kam kyçin!
Derën aq të dashur un'e çel!
Nuk e gjeta vashëzën në sallë,
Nuk e gjeta vashëzën në odiçkë,
Më në fund, kur dhomën un'e hapa,
Mi sofa të saj un'e gjej shtrirë,
Duke fjetur ëmbël me gjith rrobe.
Kish dremitur me gjith punëdore;
Punë e shtija ndodheshin nër duar,
Duarkryq, të njoma e delikate;
Dh'unë ndenja pranë saj i heshtur,
Pyeta veten, vallë a mos e zgjova.

Ja sodita qetësinë e bukur,
Q'i përderdhej përmi dy qerpikët:
Buza kish besnikërinë e ëmbël,
Të dy faqkat, dashuri mitare,
Dhe një zemr'e mirë dh'e pafajshme
Rëgëtinte posht e lart në gji.
Çdo gjymtyrë i shkrihej dëfrimplote
Nga balsami i ëmbl'i Perëndisë.
Unë rrinja plot gëzim, dhe pamja
Ma përmbante shtytjen për ta zgjuar
Me vargonj të fshehtë e të pazgjidhur.

Dashuri! mendonja, mund ty gjumi.
Tradhëtonjësi i çdo vijze false,
Mos të të dëmtojë, mos zbulojë
Gjë të keqe për idenë e mikut?
Janë mbyllur syt' e tu të bukur,

Që, të çelur, ma rrëmbejnë mëndjen;
S'të lëvizin ato buzë t'ëmbla
As për fjalë e as për një të puthur;
Shkrirë janë ata vargonj magjie,
Krahat, që përhera më pushtojnë,
Dora jote, shoqja magjiplote
Që më përkëdhelte, nuk lëvis,
T'ish gabim, ajo që them për ty,
T'ish gënjim i vetes, si të dua,
Mund ta shihnja sot, pra, kur Amori
Me sy zgjidhur pranë më qëndroj.

Ndenja ashtu mjaft kohë dhe dëfrenja
Prej asaj dhe dashurisë sime;
Më pëlqeu aq shumë ashtu në gjumë,
Sa s'kuxonja kurrsesi ta zgjoj.

Lehtas un'i ve dy portokalle
Dhe dy trëndafilë mi tryezë;
Mengadal zë prapë rrugën time.

Hap, e Mira ime syt'e saj,
Sheh sakaq dhuratën e larishme,
Dhe çuditet, si me derë mbyllur,
Ky kanisk i dashur mund t'i falet.

Engjëllin n'e pafsha këtë natë,
Se ç'gëzim do ketë! ajo dyfish
Dashurinë do të ma shpërblejë.



## RJETË MAGJIKE

Vallë, mos shikoj luftime,
Apo lodra dhe çudira?
Pesë djem nga më të mirët
Ziren kundër pesë mostrash,
Rregullisht, me takt të fortë,
Siç dha urdhër magjistarja.

Shtijzat u shkëlqejnë atyre,
Po këtë na mpleksin penjët,
Që beson njeriu, se n'hallka
Hekurat do kapen keq.
Shtijzat befasisht u kapën;
Po nga dansi i lehtë i luftës
Zhduket njëri, zhduket tjetri
Nga vargoj i hallkave,
Që sakaq e kap të lirin,
Dh'e lëshon të lidhurin.

Kështu me fitore e humbje,
Ikje e ardhje e kthim të shpejtë,
Mplekset mjeshtërisht një rjetë
Gjyrë-bardhë si dëbora,
Që, prej hallkës më të çelur,
Vjen e errët vazhdimisht,
Si s'e bëjn' aq lehtë as gjurat.

Kush pra do ta marri rroben
Madhështore? Kush do jetë
Shërbëtori i Zonjës sonë
Fort të dashur, fort të ëmbël?

Mua ma jep fat'i hirshëm
Shënjëzën e dëshiruar!
Dh'unë i përqafuar ndjehem
Shërbëtor i saj besnik.

Po kur unë, madhështor
Kaq me ëndje bëj e endem,
Ja! të lirët ku po mpleksin
Fshehtësisht, pa zënkë fare.
Rjeta t'himëta të reja,
Fije muzgu, rreze hëne,
Erë nate manushaqesh.

Para se ta shohim rjetën,
Mbet i kapur një i lumtur,
Që ne gjithë, plot urime,
Plot zili, e përshëndesim.



## GOTA

Mbanja gotën bukur të gëdhëndur,
Me dy duar fort duk'e shtrënguar,
Pinja i etshëm verëzën e ëmbël
Për të zhdukur brengën e trishtimin.

Erdh Amori dhe më gjet si rrinja
Dhe i përulur zu po buzëqeshte
Duke i ardhur keq për mëndjen time.

«Unë di një gotë më të bukur,
Ku të derdhish, mik, gjithë zemrën tënde.
Ç'më premton ti në ta falça gotën,
Në ta mbushça me nektar të ndryshmë?»

O, sa mirë ay e mbajti fjalën
Që ty, Lida, ay plot hir për mua,
Fort të dëshiruarin, të fali!

Kur ta marr ty kurmin aq të ëmbël
E ze pi prej buzëve besnike
Dashurinë me balsam shëronjës,
Shpirtit tim i lumtur un'i them:

Jo, një gotë, si këtë s'ka patur
Kurrë ndonjë Zot, përveç Amorit.
Të këtilla forma s'bën Vulkani
Me çekanët e mërekulluar!
Përmi kodra pyjesh mund Likusi,
Me ato kafshët plot me mënçuri,
Të përhapi rrush nga më të mirët,
Duke ndenjur urtë pranë zjerjes:
Të këtillë pije ay s'bën dot!

## MENDIME NATE

Më vjen keq për juve, yj të mjerë,
Q'ini t'hijshëm e që ndritni bukur,
Q'udhëhiqni në rrezik lundrarin
Pa shpërblim nga zotërit e njerzit.
Se ju s'dini ç'është dashuria!
Pa ndaluar, orët e përjetshme
Ju drejtojnë përmes hapësirës.
Ç'udhëtimi i dhatë fund ju vallë,
Që kur unë e dashurorja ime
Ju harruam juve dhe mesnatën?



## LIDA-S

Të vetëmin, Lida, që ti mund ta dashurosh,
E kërkon veç për ty, dhe me të drejtë.
Dhe ay është vetëm i yti;
Sepse, që kur unë jam i yti,
Më duket lëvizja zhurmonjëse
E më së shpejtës jetë
Veç si cipëz e hollë, përmes së cilës shtatin tënd
Unë e shoh gjithnjë si nëpër re:
Ay më ndrit i ëmbël dhe besnik,
Ashtu siç ndritin përmes aurorës boreale
Yjt'e përjetshëm.

## MALLËNGJIM

Ju po fishkeni, moj lule,
Nuk më faltë dashuri;
Çelni, ah! të m'ipni shpresë,
Në këtë trishtim të zi.

Më kujtohen ato ditë,
Kur barisnim që të dy,
Kur në kopshtin tim më dilnin
Gonxhe t'hapura nër sy;

Lulet, Engjëll, ty t'i shtronja
Nënë këmbë pa pushim,
Dhe përpara pamjes sate
Mirrnja shpresë e përgjërim.

Ju po fishkeni, moj lule,
Nuk më faltë dashuri;
Çelni, ah! të m'ipni shpresë
Në këtë trishtim të zi.



## DHËNDRI

Në mes të natës flinja. Zemr'e ngratë
Përgjonte nënë gji sikur t'ish ditë;
Kur dita erdh, më dukej posi natë;
Ç'dobi për mua gjith kjo ditë e dritë!

Ajo mungonte; shkrihej puna ime,
Veç për atë në vlagë e nxehtësirë
Të ditës; po ç'gëzime dhe dëfrime
Kur vinte mbrëmj'e freskët! O, sa mirë!

Anohej diell'i vonë; të betuar,
Ne u përshëndetmë me përzemërsi,
Dhe i fliste syri syrit të kulluar:
Nga Lindja ajo do vijë përsëri!

Në mes të natës yjet ma drejtojnë
Drejt saj në ëndër shpirtin plot dëshirë,
O, dua pranë saj të më pushojnë
Këto gjymtyrë — jeta ësht'e mirë.

## DUKE U NGRITUR HËN' E PLOTË

Ishe këtë ças kaq afër!
Shpejt e shpejt ti po më le?
T'errësojnë retë e zeza,
Dhe tashi këtu më s'je.

Po ti ndjen, se sa po vuaj,
Ndrit si yll rreth e përqark!
Thua, jam i dashuruar,
Ndonse e dashura ësht' larg.

Ngjitu pra! Gjithnjë m'e ndritur,
Shtegëto me madhështi! —
Le të më tronditet zemra —
Nata është plot lumtëri.

---

Kur n'agim, nga male e gryka,
Nap'e mjergullës përhapet,
Dhe kur pritjes së përmallshme
Lulja plot me lëng i hapet;

Kur ethiri i zi me ditën
Merr e jep duke luftuar,
Dh'er' e Lindjes ia fryn retë
Para diellit të kulluar:

Atëhere, këtë pamje
Ti me afsh duk'e shijuar,
Do vështrosh si skuqet dielli
N'orizontin e praruar.



Mua ditën largësirat
Më tërheqin fshehtësisht,
Më shëndritin yjt'e natës
Përmi kryet madhërisht.

Dhe lëvdoj çdo ditë e natë
Fatin tënd, që ke njeri,
Kur ti je përjetë i drejtë,
O, sa hije e madhëri!

---

## PARABULLA

### I

Mësonjësi i një shkolle fshati
U ngrit nga froni duke u hedhur
Dhe desh të frekuentojë i gjori
Një shoqëri që t'ish m'e zgjedhur;
Pandaj në banjën më të afërt
U fut në një sallon si mik,
Po ngeli, kur iu duk se rrethi
Ish përsëtepërmi fisnik;
I bën një t'huaji aty djathtas
Një reverencë që s'ish keq.
Po prapa nuk ja mori mëndja
Se kish dh'aty rrëmet për dreq,
Dh'e shtyri majtas fqinjën tjetër
Duk'e goditur me mullaq.
Ish gati për t'i lypur ndjesë;
Po kur u ndreq me të sakaq,
Së djathti shtyri dhe një tjetër,
Kështu një tjetr' ay dëmtoj.
Dhe pasi prap'u bë për ndjesë,
Iu rënd një tjetri kësisoj.
Mërziti veten përmes sallës
Përpara e prapa kafsh'e trerë,
Gjersa, në rund, një topatan
E ftoj të zhduket nëpër derë.

Sikush që mund të bëjë faj,
Le të mësojë prej kësaj.



### II

Ky miku pra, tek ecte rrugës,
Tha: rashë fort unë qyqari;
Po paskëtaj unë s'do përulem;
Kush bëhet bar, e ha gomari.
Vazhdoj përpara me kurajë,
Jo duke hipur, duke zdrypur,
Po nëpër ara dhe livadhe.
Çdo gjë me këmbë duk'e shtypur.

I del në ballë një pronar
Dhe nuk e pyet as ku? as si?
Po ja kërcet sakaq me grusht —
Oho, seç linda përsëri!
Bërtet shtegtari jonë i lumtur.
Kush je, o shpëtimtari im?
Më dhëntë Zot'i madh përherë
Të tillë shokë për gëzim.

## LEGJENDË

Kur, i panjohur e i paçmuar
Mi tokë Krishti shegëtonte,
Me nxënës plot që, shumë rrallë
Ndonjëri fjalën ja kuptonte,
Ndalohej për së gjati rrugës,
(Kjo gjë i pëlqente atij pa masë),
Sepse përjashta, nënë qiell,
Njeriu më mirë mund të flasë.
Ia thesh mësimet më të larta
Nga goj'e ti e shenjtëruar,
Në tempull, mes paravolirash,
Çdo pjacë e treg duk'e ndryshuar.
Kështu, dikur, Zoti i vërtet,
Po vinte për në një qytet,
Çapitej lehtë edhe më nge,
Sheh një potkua aty përdhe,
Papo Shën Pjetrit iu drejtua:
«O Pjetër, ngrehe atë potkua!»
Shën Pjetri s'ishte sot më të,
Se n'ëndër erdh edhe i u bë
Një mbretëri për bukuri:
Sundonte ay mi çdo njeri:
Kjo brënda kokës ka fuqi,
Sikujt i jep kënaqësi;
Kështu mendonte Pjetri plak,
Po ç'ngjet përdhe, nuk vlente aspak
Ish fort e vogël për shenjtorë:
Të qënke shkeptër e kurorë!
Dhe Pjetri i mburrshëm u mendua:
Pse t'ulet pra për një potkua?
Prandaj mënjanë ay dredhoj
Dhe bëri ashtu sikur s'dëgjoj.



E ngriti ahere Krishti vetë
Potkuan me durim të qetë,
Dhe bën sikur asgjë s'kuptoj,
Sikur kjo punë aty mbaroj.
Kur hynë brenda në qytet,
Ja bleu një farkëtar i shkret,
Q'i dha tri pare për potkuan.
Dhe kur në treg ata kaluan,
Sheh Krishti i mirë aty qershi,
Ble sadopak në qetësi
(Sa mund të blinte me tri pare),
Dhe i fut pa bërë fjalë,
Pa u turbulluar si gjithmonë,
Në mëngët siç e kish zakonë.

Kaluan portën e qytetit,
Më s'ndjenin zhurmën e rrëmetit,
Nër sheshe e fusha pa banim
Nuk kishte rruga gjelbërim;
Ish diell i fortë e zagushi.
Kështuqë, në këtë shkreti,
Nuk blihej uji as me flori.
Përpara, Krishti-perëndi,
Lëshonte nga ndonjë qershi.
Vërsulej Pjetri kryelarti,
Çdo kokrr i dukej moll' e artë;
Shijonte frutat me lezet;
Gjithnjë kështu, Zoti i vërtet,
Lëshonte një qershi përposh.
Vërsulej Pjetri-bukurosh.
E bën pareshtur Zoti jonë
Që t'ulet me lakmi gjithmonë,
Të mbledhi kokrrat ças për ças,
Dhe më në fund i tha me gas:
«Do t'ish më mirë, o djal'i mbarë,
Sikur të tundeshe më parë.
Kush gjën'e vogël nuk e çmon,
Pas më së voglës zë lakmon».

## NGA VILHEM MAJSTER-I

### Mignon

Jo të të flas, po t'hesht më thuaj,
Se një sekret më detyron;
Do të t'i thesha ç'kam e sa po vuaj,
Po fati i rëndë nuk lejon.

Kur i vjen ora, ngrihet dielli i ri
Dhe terri i natës bëhet ditë e dritë;
I forti shkëmb le shteg në gji të ti
Dhe kroj murmurimtar shpërthen nga thellësitë.

Sikush kërkon ndaj shokut qetësin',
Aty qepallës mund t'i bjerë loti
Po gojën time e mbylli një betim,
Dhe për ta hapur s'mund përveç se Zoti.



# ART

## PIKAT E NEKTARIT

Kur Minerva, duke i bërë
Prometeut një favor,
Këtu poshtë, që nga qielli,
Zbriti kupën me nektar
Për t'i lumtëruar njerzit
Dhe me artin qiellor
Gjirin për t'ua frymëzuar:
Ajo rendi me nxitim,
Që mos ta shikonte Zeusi:
Kështu kup'e artë u tund
Dhe pikuan disa pika
Përmi tokën e bleruar.

Plot me zell ahere bletët
Erdhn'e pinë një nga një;
Erdhi flutura mitare,
Që të kapi ndonjë pikë;
Po dh'e ndyra marimagë
Pi me et duke u zvaritur.

Fort të lumtura shijuan,
Me gjith kafshëza të tjera!
Se, me njerzit, ato ndajnë
Lumtërin' e bukur, artin.

SHTEGTARI

**Shtegtari**

Zoti të bekoftë, grua e re
Me djalkën që thith,
Në gjirin tënd!
Më lejo ndaj shkëmbit këtu,
Në hien e vidhit,
Të le barrën time,
Të çlodhem pranë teje.

**Gruaja**

Ç'punë të shtyn këtej
Nëpër vapën e ditës
Mi këtë vrragë me pluhur?
Sjell ti plaçka prej qytetit
Nëpër fshatra?
Qesh, o i huaj
Me pyetjen time?

**Shtegtari**

Nuk sjell plaçka prej qytetit.
Po freskohet tashi mbrëmja;
Tregoma kruan
Ku ti pi ujë,
Grua e re e dashur!



**Gruaja**

Këtej lart vrragës së shkëmbit.
Ecë përpara! Nëpër kaçube,
Vrraga shkon në kasollen
Ku banoj unë,
Te kroi,
Ku pi ujë unë.

**Shtegtari**

Shenja rregulli të dorës së njeriut
Midis shkorretave!
Këta gurë s'i ke bashkuar ti,
Natyrë dhurëtiplotë!

**Gruaja**

Më tej, lart!

**Shtegtari**

Një arkitrav i mbuluar me myshk!
Të njoh, shpirt krijonjës!
Ke vulën tënde mi gur.

Më tej, i huaj!

**Shtegtari**

Një mbishkrim, përmi të cilin unë po shkel!
I palexuarshëm!
U zhduktë,
Fjalë thellësisht të gdhëndura,
Ju që mendimin e Mjeshtrit tuaj
Do t'ua tregonit mijra nipërve.

**Gruaja**

Çuditesh, i huaj,
Me këta gurë?
Atje lart ka shumë gurë
Rreth kasolles sime.

**Shtegtari**

Atje lart?

**Gruaja**

Ja më të mëngjër,
Duke ngjitur shkurret,
Këtu.

**Shtegtari**

Ju o muza dhe Gracie!

**Gruaja**

Kjo është kasolla ime.

**Shtegtari**

Gërmadhat e një tempulli!

**Gruaja**

Këtu mbanë, përposh
Mburon kroi
Ku pi unë.

**Shtegtari**

Me afsh të zgarrshëm ti rëgëtin
Përmbi varrin tënd.
Gjeni! Mbi ty
Është shembur
Kryevepra jote,
O i pavdekshëm!



**Gruaja**

Frit. p' marr enën
Që të pish.

**Shtegtari**

Lerthi ka pësht,ellë
Formën tënde të perëndishme
Si ngrihesh ti lart
Prej gërmadhave,
Çift kollonash!
Dhe ti motër e veçuar atje,
Me myshk mi kokën e shenjtë,
Si vështroni ju përposh,
Nër këmbë,
Madhërisht duke rënkuar,
Mbi shoqet tuaja
Të bëra copë!
Në hijen e gëmushës së manave
Ato i mbulon dheri dhe gërmadha,
Bar i lartë tundet përsipër!
Çmon ti kështu, Natyrë,
Kryeveprën e kryeveprës sate?
Pa ndjerë dërmon ti
Tempullin tënd?
Mbjell atje gjemba?

**Gruaja**

Si fle djali!
Do të çlodhesh në kasolle,
O i huaj? Do më mirë të rrish
Këtu jashtë?
Është fresk! Merre djalin,
Të vete unë për ujë.
Fli, shpirtkë! fli!

**Shtegtari**

I ëmbël është pushimi yt!
Si merr frymë qetësisht,
Me shëndet qiellor!
O i linduri përmbi mbeturinat
E së kaluarës së shenjtë,
Le të pushojë fryma e saj mbi ty!
Atë që ajo e rrethon,
Do t'i shijojë gjithë ditët
Me një ndjenjë të perëndishme.
Gjithnjë i mbarë, rritu e lulëzo,
Stoli madhështore
Në parëverën plot shkëlqim,
Dhe ndrit përpara shokëve!
Dhe duke u fishkur mbulesa e lulëzimit.
Ahere le të ngrihet prej gjirit tënd
I ploti frukt
Dhe le të maturohet drejt diellit.

**Gruaja**

E bekoftë Zoti! — Edhe po fle?
S'kam gjë tjetër me pijen e freskët,
Veçse një copë bukë, për t'ju dhënë.

**Shtegtari**

Të falem nderit,
Sa madhërisht lulëzon këtu çdo gjë
Dhe gjelbëron.

**Gruaja**

Burri im vjen së shpejti
Në shtëpi
Nga fusha. O rri, rri Zot!
Të hash me neve darkën.

**Shtegtari**

Banoni këtu?



**Gruaja**

Këtu, midis këtyre murishtave
Kasollen e ka ndërtuar im at
Me tulla dhe me gurët e gërmadhës.
Këtu banojmë ne.
Ay më dha te një bujk
Dhe vdiq në krahat tona. —
Fjete, shpirt i dashur?
Sa me qejf është dhe do të lozë!
Çapkën!

**Shtegtari**

Natyrë! përjetësisht mbinjëse,
Ti e krijon secilin për ta shijuar jetën.
Ke pajisur gjithë fëmijët e tu mëmërisht
Me pjesë trashëgimi, një kasolle.
Dallandyshja ngreh lart folenë,
Pa ndjerë se çfar' stolije
Do të ngjizi.
Dhjemja pështiell degën e artë
Si shtëpi dimri për pjellën e saj;
Dhe ti ngjiz midis gërmadhave madhështore
Të së kaluarës,
Për nevojat e tua,
Një kasolle, o Njeri,
Dëfren sipër varresh! —
Lamtumirë, grua e lumtur!

**Gruaja**

Nuk do të rrish?

**Shtegtari**

Zoti me juve,
Bekoftë djalin tuaj!

**Gruaja**

Udh'e mbarë!

**Shtegtari**

Ku më shpje ajo vrragë
Atje mi mal?

**Gruaja**

Në Kumë?. [1])

**Shtegtari**

Sa mban gjer andej?

**Gruaja**

Tri mila të mira.

**Shtegtari**

Lamtumirë!
O, primi hapat, Natyrë!
Prija të huajit, çapin shtegtar,
Të cilin unë e bëj
Përmi varret
E së kaluarës së shenjtë.
Prije atë në strehim,
Të mbrojtur prej Veriut,
Dhe ku nga rrezet e mesditës
Mbruan një korie shelgjishtash.
Dhe duke u kthyer më pastaj
mbrëmave
Tek kasollja,
E praruar nga rrez' e fundit e diellit,
Le të më presi një grua e tillë,
Me djalkën në krah!

---

1) **Cumä (gërq. Kyme), koloni e stërlashtë greke në Itali (Kampanjë).**



## AMORI SI PIKTOR

### PEISAZHI

Rrinja në mëngjes mi majë shkëmbi,
Ngulnja sytë larg e larg në mjerguil;
Si qilim i hirtë ajo e nderë,
Posht'e lart i fshihte që të gjitha.

Erdh një çun e ndenj aty mënjanë,
Tha: «I dashur mik, si mund ti vallë
Të shikosh kështu më nge qilimin?
Mos ke humbur vallë përngahera
Çdo dëshirë për të pikturuar?»

E vështrova djalin edhe thashë:
Dashka çuni t'ja kalojë mjeshtrit!
«Në paç qef të rrish pa punë e i zymtë»
Foli djali, «s'bën dot gjë të mirë:
Ja, do bëj pra një tabllo të bukur,
Të mësosh të bësh edhe ti vetë».

Dhe u drejtua gishti i tij rrëfenjës,
Q'ish i kuq si gjyrë trëndafili,
Tek qilimi i shtruar më të largët,
Zu me gishtin shpejt të vizatojë:

Pikturoj një diell fort të bukur
Që më ndritte larg përpara syve,
Çdo qenar të reve e bëri t'artë,
Retë i shpoi përmes me rezatime;
Lehtë i pikturoi pastaj në maja
Drurët e freskuar, bëri kodrat,

Një nga një, me gisht të lirë prapa;
Poshtë fare nuk mungoi as uji,
Vizatoj një lumë të natyrshem,
Që shkëlqente nënë rreze dielli,
Që i lëshonte lart mi breg buçimat,

Ah, kish lule shumë pranë lumit,
Edhe ngjyra mbi livadhe e mezhda,
Gjelbërim e ar e zjarr e purpur,
Gjith smerald e gjith rubin të flaktë!
Pastër e llustros ay dhe qiellin,
Malet gjyrë kaltra atje së largu,
Kësisoj, q'i zjarrshm'unë sodisnja
Kur piktorin edhe kur pikturën.

«Ja», më foli ay, «të kam provuar,
Zotësinë time mjeshtërore;
Po, m'e rënda, vjen më pas menj'herë».

Vizatoi pastaj me majë gishti,
me kujdes të madh, aty ndaj pyllit,
Mu në fund, ku dielli i fortë ndriste
Duke u kthyer rish nga tok'e qartë,
Vizatoi një vajzë bukuroshe,
Me shtat t'hijshëm, veshur lehtë e hollë,
Dhe me faqkat gjyrë trëndafili,
Posi gishti q'i pat pikturuar.

«O djalosh!» — bërtita unë, «ç'mjeshtër
Të pat marrë, siç kujtoj, në shkollë,
Që ti kaq menj'herë e kaq natyrshëm
Çdo gjë mirë e nis dhe mirë e kryen?»

Kur po flisnia ashtu, ja, zë të tundet
Nj'erë e vogël dhe lëvis kodrinën,
Mbush me dhënka valët përmi lumë,
Fryn pëlhurën vajzës së përsosur.



Dhe, ajo që më çuditi shumë,
Ze dhe vajza të lëvizi këmbkat,
Vjen afrohet n'atë vënd ku unë
Me mësonjësin e madh po rrinja.

Dhe me qenë që tashi lëvisnin
Drurët, lumi, lulet dhe pëlhura
Dh'ajo këmbk'e lehtë e bukuroshes,
Thoni ju se unë sipër shkëmbit
Si një shkëmb i qetë e i fortë mbeta?

---

## SHOQËRI

Po kthehej nga një shoqëri
Një dijetar për në shtëpi,
Dhe kur e pyetnë si pat shkuar?
Tha: «Si një librë e pakuptuar...»

---



## NDALIM

Mendimi i mirë, do t'ish mirë,
Veç me një gjak, me një dëshirë;
Mendimi yt me gjakun tjetër
Të shpje në kundërshtim pa tjetër.

---

Do të punonja pa pushuar,
Po do të rri:
S'punoj më dot, siç kam punuar;
Pa qejf e pa kënaqësi.

---

Të mbetem si mësonjës, s'do t'isha kundërshtonjës
Sikur gjith këta nxënës mos dilnin shpejt mësonjës.

---

## MËNYRË JETESE.

Kur ndrrojnë zotërinjtë e moti,
Në ballë mos u rrudh së koti,
Dhe kur bën naze femr' e bukur,
Kënaqu vetëm në të dukur.

---



## KUSHT

Ju nuku mprapsi, s'është punë,
Doni këshillë, e jap siç doni;
Po që të jem i qetë dh'unë,
Premtoni se pas saj s'do shkoni.

---

## GJËJA MË E MIRË

Kur kok' e zemër të gjëmon,
Më mirë ty ç'të k'ënda?
Kush më s'gabon, më s'dashuron,
Në varr le t'hyjë brënda.

---



## VEZË E FRESKËT, VEZË E MIRË

Entusiazmi, o zotëri,
Është si stridhja q'un'e thëthi,
Që, kur të freskët nuk e shijon,
Ngjan me një gjellë që ty s'të shkon,
Entusiazmi s'është sardellë,
Që, për rezervë, kripet si gjellë,

---

## PLEQËRIA

Kjo pleqëria, një bujar:
Troket ngadal e me karar,
Pa «hyrë!» nuk dëgjon njeri
Dhe para derës ay s'rri
Kur... befas hyn e s'lot e s'ik:
I thonë: «Ç'burrë trashanik!».

---



## PËR PROTESTANTIN GJER TASHI

Për protestantin gjer tashi
Plot treqind vjet provojnë,
Se Papë e Turk n'ato Seli
Me urdhrat i zemrojnë.

Kur çpif një pop [1]) — një shpirtdinak —
Predikatori [2]) hap gojë,
Dhe që mos prishë armiku plak
Rri çdo gjerman në rojë.

Dhe unë, o Zot, sa kam fuqi,
S'e le pa përdoruar —
Si gjithnjë, n'art e dituri
Kam për të protestuar.

---

1) Pop = prift.
2) Predikatori = (Predikatori protestant)

# NGA POSTUMET

## BËRTITJA

Mes pyllit ku njeri më s'ka
E ndoqa vashën pas
Dhe zura ta pushtoj, dhe «ah»,
Kanoset, «do bërtas».

«Ha!» thirra, «do ta vras ta sos
Kush vjen na turbullon!» —
«Mos!» pëshpërin, «i dashur, mos!
Se bota na dëgjon».

---



## DASHURI DHE VIRTUT.

Kur vajzës që na dashuron
E jëm' e ashpër i mëson
Virtut, detyrë, e pastërsi,
Po vajza s'bindet kurrsesi
Dhe fluturon më lozonjare
Tek puthjet tona shpërblimtare:
Ahere kokëfortësia
Ka pjesë sa dhe dashuria.

Po nënës kur s'i bje vështirë
Ta zbuti zemërën e mirë,
Dh'e zotëron një mburrje e kotë.
Që vajza ik prej nesh e ftohtë —
Ahere ajo s'ka ditur gjë,
Se kur një vajzë e bën këtë,
Ka pjesë aty lëkundshmëria
Më shumë se sa ndershmëria.

---

## DASHURI PA DASHUR

Un'e di mirë e tallem shumë
Ju vajza jeni për në lumë!
Ju dashuroni pa dallim
Davidin dh'Aleksandrin trim;
Sikush më vete ka fuqi,
Dhe për sho-shokun mirësi.

Po unë vuaj si më parë,
Si mizantrop fytyrë-vdarë,
Një skllav i shkretë i dashurisë!
Shpëto, moj zemr' e bërë pisë.
Po zemra dhemb në thellësi,
Me tallje, s'ik kjo dashuri.

---



## ZONJUSHËS N.N.

Me zemër ajo shëmbëllen
Si një Parajsë e si nj'Edden;
Se miqt' e ftuar
Me qënë që s'i vanë,
Fton e zemruar
Ulogë e çalamanë.

---

## PAS ITALISHTES

Ju mos qani, o fëmijë,
Që s'ju linda gjer më sot:
Se tronditet ati juaj
Dhe i mbush sytë plot me lot.
Prisni, prisni, gjer të lindni,
Dhe pak kohë, me durim:
Në s'ju lind dot ati i mirë,
ju lind nëna pa dyshim...

---



## KUJTIM.

**Ay.**

Të vjen ndër mënd një herë
Kur duheshim me zjarr?

**Ajo**

S'të shihnja dot përherë,
Më bëhej dita varr.

**Ay.**

Sa mirë! Gjith bashkuar,
Që më gëzon sërish.

**Ajo**

Dhe shok me shok mashtruar;
Sa kohë e bukur ish!

---

# LIRIKA

## PARIA

### LUTJA E PARIA-S

Brahma i madh, i plotfuqishëm!
Fara jote ësht' anembanë,
Ti je drejtësia vetë!
Bëre, Brahma, veç brahmanë,
Veç raxhanj [1]) e veç të pasur,
Apo bëre dhe majmunë.
Bëre dhe nga far'e ndohtur,
Nga kjo farë siç jam unë.

S'quhemi ne dot të zgjedhur,
Veç e keqja është jona;
Ç'ësht'e vdekshme për të tjerët,
Veç ajo i shton radhët tona.
Le të vlejë kjo për njerzit,
Njerzit le të na përçmojnë;
Porse ti, ti Brahma, çmona,
Shaji që të të kuptojnë.

Bëmë mua, Zot, të lutem,
Birin tënd ashtu siç dua,
Ose një diçka me tynë
Bëj që të më lidhi mua!
Se një Perëndi iu ngrite
Bajaderave pa druar:
Ne pra një çudi të tillë
Presim për t'ju lavdëruar.

---

1) Raxha = titull i princëve në Indi.



## LEGJENDË

Shkon për ujë zemërpastra,
Zonj' bukur e Brahmanit,
Q'sht'i pastr' e i adhuruar,
Mbushur plot me drejtësi.
Dit' për'ditë ajo merr ujin
Freskimtar nga Lum'i shenjtë;
Po pse s'ka bardhak e stomnë?
S'ndjen nevojë ajo për to.
Për të drejtët, të pafajshmët,
Vala duke u rrumbulluar,
Bëhet posi top kristali;
Këtë gruaja gazmore,
Zemër pastra, jetë larta,
Ja shpje burrit në shtëpi.

Vjen dhe sot ajo nër lutje
Që n'agim tek val' e Ganges,
Ulet ëmbël sipër ujit —
Po sakaq u pasqyrua
Prej Kuberash qiellore,
Sipër saj duke kaluar,
Shtat'i drejtë e hijeplot,
Trup'i hijshmë i një djaloshi,
Që mendimi i lartë i Zotit
E krijoj nga gjir'i vet;
Duke e parë ajo zë dridhet.
Plot me ndjenja turbullimi
Mu në fund të vetëvetes,
S'ngopet dot me këtë pamje,
Do ta mbrapsi, ajo del rishtas,
Dhe kështu zbret femra poshtë,

Të marrë ujë e fërgëlluar;
Porse ah! nuk merr më dot!
Sepse val'e shenjtë e ujit
Ik prej saj edhe largohet,
Ajo sheh veç gjeratore,
Hon të brazët nënë të.

Krahat varren, këmbët tunden,
Duhet vajtur në shtëpi?
Të mungojë? Apo të iki?
Zë mendon, kur as mendimet,
As këshillat s'i ndihmon
Dhe kështu del para kopshtit;
Ay fellë i shtiri sytë,
Vendimtar e kapi shpatën,
E zvarit te Kodr'e vdekjes,
Ku gjakosen faj-mëdhenjtë;
Mund ajo të kundërshtojë?
Mund ajo të çfajësohet.
E pafajshmja plot me faj?

Dh'ay kthehet shpatë-skuqur
Plot mendime në shtëpi,
Biri i vet i del përpara:
«Ç'gjak ke derdhur? At! o At!» —
«Gjakun e fajtares!» — «Jo!
Sepse s'ësht' i mpiksur gjaku
Posi gjak prej mëkatari;
Rrjedh si nga një plagë e freskët.
Mëmë, mëmë! Dil këtej!
Kurrë im at s'ish i padrejtë,
Thuaj, ç'bëri ay tashi?» —
«Heshtë! Heshtë! gjaku i saj!» —
«I kujt është?» — Heshtë! Heshtë!
«Gjaku i mëmës, mëmës sime.
Ç'pati ngjarë? Ç'faj ka bërë?
Shpatën, shpatën! ja, e kapa;
Gruan tënde mund ta vrasësh,



Porse mëmën time, jo!
Drejt në flakë bashkëshortja
Vjen pas burrit që mbaron,
Drejt në flakë, biri i dashur
Vjen pas mëmës q'adhuron.

«Ndal, o ndal!» bërtiti i ati
Kemi kohë, po më shpejt!
Ngjitja trupit kokën rishtas,
Dh'ajo gjallë të vjen pas».

Duke rendur e pa frymë,
Djali sheh dy trupa grash
Kryq-tërthori, ashtu dhe kokat;
Ç'pamje e tmershme! Zgjedhje e tmershme!
Pastaj kap kokën e mëmës,
Nuk e puth aspak, të zbetën,
Po mi trupin aty pranë
E ve shpejt edhe me shpatën
Bekon aktin e devoçmë.

Ngjallet shpejt një shtatvigane;
Dhe nga goj'e ëmbl'e mëmës,
Yjërisht e pandryshuar,
Ndjehet fjala tërë tmer:
«Bir, o bir! Ç'punë e nxituar!
Ndaj kufom'e mëmës sate,
Kok'e keqe e mëkatplotës,
Therrorisë që pat lypur
E përjetshmja Drejtësi!
Mua ti më pate ngjitur
Përgjithnjë tek trup'i saj;
Vullneturtë, vepëregër
Midis Zotërve do jemi.
Po, Djaloshi i perëndishmë,
Dhe hirplot përpara meje:
Dhe më zbret në fund të zemrës,
Ma bën shpirtin lakmimtar,
Gjithënjë do të më çfaqet,
Do të ngrihet, do të zbresi,
Do të vrënjtet, do të ndritet,

Kështu Brahma e urdhëroi.
I dha urdhër kraha lehtit,
Pamje dhe gjymtyrë ndriçmit,
Mrekullis' së perëndishme,
Mua për të më provuar;
Se që lart na vjen provimi,
Zotërve siç u pëlqen.
Kësisoj, unë Brahmania
Ndjej, me kokën lart në qiell,
Posi Paria, se dheri
Më tërheq me vrull përposh.

Bir, po të dërgoj tek ati!
Mbahu! Asnjë pendim i hidhur,
Këmbëngulje e rëndë, mburrje,
Mos t'ju mbajë n'egërsim;
Dilni nëpër gjithë botën,
Ecni nëpër gjithë kohët,
Jipni lajme dhe më të voglit:
Sepse Brahma e dëgjon!

Për atë s'ka më të vogël;
Kush i thyer nga gjymtyrat,
Me gjykim të shkatërruar,
Pa shpëtim edhe pa shpresë,
Qoftë Paria, a Brahman,
Kthehet me vështrim së larti,
Do të ndjejë, do të gjejë:
Atje ka njëmijë sy,
Atje ka njëmijë veshë:
Për asgjë të fshehtë s'ka.

Kur t'i vete lart te Froni,
Të më shohi, gjëmëmadhen,
Q'ay keq më pat ndryshuar,
Përgjithjetën do t'i dhimbem,
Ju nga kjo të përfitoni!



Dh'unë atij do t'i kujtoj,
Dh'unë atij do t'i them egër,
Ashtu siç ma thotë mendja,
Ashtu siç më zjen në gji,
Ç'mendoj unë, çfar ndjej unë —
Kjo të mbetet fshehtësi».

### Falënderimi i Paria-s

Brahma i madh! tashi kuptoj
Se ti botët ke krijuar!
Ty të njoh si Zotin tim,
Sepse ti i lejon të gjithë,

Dhe s'i mbyll as më të fundit
Asnjë nga njëmijë veshët;
Ne, të zbriturit nga poshtë,
Që të gjithë na rilinde.

Ktheuni pra tek kjo grua,
Q'e bën dhëmbja perëndeshë!
Tashi unë po sodas
Shkaktarin e çdo gjëje.

## MARS

Ra një dëbor' e vonë,
Se s'është koha sot,
Të shohi zemra jonë,
Të shohi zemra jonë
Blerim e lule plot.

Gënjen ky diell'i ngrohtë
Me gjithë rrezet tok,
Dhe dallëndyshja ç'thotë;
Dhe dallëndyshja ç'thotë.
Gënjen, se vjen pa shok!

Ç'të qesh kështu i veçuar,
Që parëvera u qas?
Po që të dy bashkuar,
Po që të dy bashkuar,
Do jetë verë e gas.



## PRILL

Sy, më thoni, thoni, ç'thoni?
Se fort thoni bukurira,
Fort kumbime e ëmbëlsira;
Dhe njësoj të pyesni doni.

Po besoj se un' e gjeta:
Prapa syve të kulluar
Rri një shpirt q'e mban pushtuar
Dashuria dh'e vërteta,

Q'ati fort do t'i pëlqente,
Nër të verbër e të mpirë,
T'ishte një vështrim i dlirë
Që ta çmonte dhe ta ndjente.

Dhe kur mua më vështroni
Ndaj thelloj këtë të fshehtë,
Gjithashtu shikoni vetë
Sytë të m'i depërtoni.

# ZOTI DHE BOTA

## PROEMION.

N'emër t'atij, që veten e krijoi,
Përjetësisht krijimtarin' ushtroi;
N'emër të tija, që krijon besim,
Fe, dashuri, fuqi dhe vepërim.
N'emër t'atij, që, kaqe shpesh q'u qojt,
Në vetë qënien kurrë nuk u njojt:

Sa larg me vesh, sa larg me sy ti shket,
Do gjesh veç gjë të njohur q'i përngjet,
Dhe sulm'i lartë, i zjarrtë i shpirtit tënd
Ka shëmbëllim, ka ngjasje kënd më kënd;
Ti ndjen tërheqjen, që gjith të rrëmben,
Dh'atje ku endesh, udh' e vënd shkëlqen.
Më s'nëmëron, s'mat kohën kurrëkund,
Dhe hap me hap ësht' hap pa anë e fund.



## QËNDRIM NË NDRYSHIM

Sikur ky shpërthim blerimi
Ah, një ças të kish qëndrim!
Po një prapë lulëzimi
Bje përposh në perëndim.
Të dëfrej se gjeth' i blertë
Më pru hie e vënd gazmor?
Shpejt e fshin furtun' e tmertë
Pasi ra një afsh vjeshtor.

Pemëve në iu do shijen,
Ngutu fort e merr ç'të bje
Këto vijn' e që arrihen,
Ajo tjetra mbin e re;
Ja, se me çdo shi më shumë
Ndrrohet valthi yt hirplot,
Ah, dhe në gjithatë lumë

Përsëri s'do bësh me not.
Po ti vetë! Aty ku pate
Gur të fortë e shkëmb nër sy,
Mure sheh, dhe sheh pallate,
Gjithnjë me ndryshim për ty
Iku buz' e puthj' e zjarrtë
Me atë shijen që mahnit,
Këmba që mi shkëmb të lartë
Posi dhi e egr'u ngjit.

Ajo dorë e ëmbl' e druar
Që dhuronte mirësi,
Shtati magjiplot ndërtuar
Janë tjetër gjë tashi.

E ç'ta mban nën' atë fjalë
Emrin tënd — ja ku po rent,
Rent këtej posi një valë,
Dhe vrapon për n'element.

Lerë nisj' e fund të endet
Duke u shkrirë një më një!
Dhe më shpejt se gjithë sendet
Ikë vetë përgjithnjë.
Merr prej Muzës s'ardhuruar
Të pavdekurin premtim;
Brendësirën në krahruar
Edhe formën në mendim.



## PARABAZË

Shumë vjet duke u munduar
Shpirt'i zellshm' e plot gëzim,
Po vëzhgon për t'a kuptuar
Krejt natyrën në krijim.
Dhe ndërron përjetë Njëja,
Ësht' e Madhja Vogëlsi;
Ësht' e madhe Pakëgjëja,
Si çdo lloj pas llojt të ti.
Gjith ndryshim e copë e tërë,
Larg e pranë e pran' e larg;
Duke bërë e duke çbërë —
Ç'më çudit i gjith ky varg!

# NGA GJUHË TË HUAJA

## SKOLION DASHURIE NEO—GREK KUSH KA TË DREJTË?

Ky konfesori i shpirtit tim;
Më këshillon ngaherë:
«Vëlla, për fajet agjëro,
Një ditë pa ndërprerë.

Po kjo Margit'e shpirtit tim
Më fton gjithnjë për darkë
Dhe thotë: «Konfesorin plak
E futtë djalli n'arkë!»



## BALLADË E LASHTË SKOCEZE

Dhe nesër është Shën Martin,
Dhe gruaja burrin e do;
I bën puddinge të mira fort.
E mbush tiganin me to.

Tashi po dirgjen të dy në shtrat,
Kriveci 1) jasht'u marros;
Dhe burri gruas së mirë i flet:
«Mbyll derën paq me llos».
«S'jam çlodhur edhe, s'jam ngrohur edhe,
Më duhet pak qetësi;
Sikur të kërcasi njëqind e një vjet,
S'ta mbyll askurrsesi».

Pastaj ata na 'zunë një bas,
Ngadal në vesh të dy:
Ay që do flasi të parin kuvënd,
Ta shtyjë llozin ay...

Dhe vijnë dy shtegtarë në terr,
S'e shquajnë vëndin dot,
Se llamba u shojt dhe vatra u shojt,
Shikojnë rrotull më kot:

«E ç'vënd i mallkuar qënka ky?
Më s'bën njeriu durim!»
Po bashkëshortët s'dëgjuan asgjë —
Kish dera faj e gabim.

Puddingun e bardhë e hëngrën ata,
Mënge që ç'ke me të.
Me vete gruaja shumë thesh,
Po s'thesh asgjë me zë.

Dhe njëri shtegtar na foli pastaj:
«Kjo gryka mua m'u tha!
Dollapi i hapur bje erë raki,
Do ketë aty diçka;

Një shishe të mbushur dora më zu,
Se ç'fat për bukuri!
Ta jap e ma jep, ma jep e ta jap,
Do marrim forcë e fuqi».

Po burri i mirë u hodh me vrull,
I shau e keq uluriu:
Sakaq këtu ta paguajë shtrenjt,
Ay që rakinë ma piu!»

Dhe gruaja shpejt e me gas u hodh
Tre hapa, përtej, si fatos:
«Hej, burrë, ti fole të parin kuvënd —
Ma mbyll tashi atë llos!»



## TRYEZA E LËNDËS


| | Faqe |
|---|---|
| Kushtim | 15 |

KËNGË

| | |
|---|---|
| Mirëdashësve | 19 |
| Amadisi i ri | 20 |
| Kristja | 21 |
| Shpëtim | 23 |
| Biri i muzave | 24 |
| Këngë alternative dansi | 26 |
| I vetë - gënjyer | 28 |
| Nxënësi argjëndar | 29 |
| Ndjenja të ndryshme në një pjacë | 31 |
| Kush ble amoreta? | 33 |
| Lamtumirë | 35 |
| Nat' e bukur | 36 |
| Gëzim dhe ëndërim | 37 |
| Kujtim i gjallë | 38 |
| Lumtëri largësie | 39 |
| Nat' e parë | 40 |
| Pafajësi | 41 |
| Si i vdekur | 42 |
| Së zgjedhurës | 43 |
| Humbj' e parë | 44 |
| Afërsia e të dashurit | 45 |
| Së larguarës | 46 |
| Mbanë lumit | 47 |
| Ndryshim | 48 |
| Këshillë | 49 |
| Vozitje e lumtur | 50 |
| Kujtim | 51 |
| Dashuri e re, jetë e re | 52 |
| Belindes | 53 |
| Këngë maji | 54 |
| Me një gjerdankë të artë | 56 |
| Lotkës | 57 |
| Mi liqer | 59 |
| Sulejka | 60 |
| Ndjenjë vjeshte | 61 |
| Ngushëllim mes lotësh | 62 |
| Mall | 64 |
| Zemrës së artë që ay mbajti në qafë | 66 |
| Embëlsi mallëgnjimi | 67 |
| Këngë nate e gjahtarit | 68 |
| Hënës | 69 |
| Shpresë | 71 |
| Këngë përvjetori | 72 |
| Rrëfim i përgjithshëm | 74 |
| Këngë koptike | 76 |
| Venitas vanitatum venitas! | 77 |
| Gëzim lufte | 79 |
| Tryezë e shtruar | 81 |
| Detyra | 83 |
| Ergo Bibamus | 87 |
| Këngë Siqelie | 88 |
| Këngë finlandeze | 89 |
| Këngë ciganësh | 90 |

BALLADA

| | |
|---|---|
| Mignon | 91 |
| Këngëtori | 92 |
| Tradhëtia e mullinares | 94 |
| Pendimi i mullinares | 97 |
| Shtegtari dhe gjysmatarja | 100 |
| Perëndia dhe bajadera | 103 |

SONET

| | |
|---|---|
| Suprizë e fuqishme | 107 |

Faqe

KANTATË

Johana Sebus ..... 108

POEZI TË NDRYSHME

Kënga e vajtimit të gruas fisnike të Asan Agajt .. 110
Kënga e Muhametit .... 113
Kënga e frymërave përmi ujra ..... 115
Perëndesha ime ..... 117
Prometheu ..... 120
Ganimedi ..... 122
Kufi të njerëzimit .... 123
E perëndishmja ..... 125
Parku i Lilit ..... 127
Nevojë dashurie ..... 131
Mall ..... 132
Musagetat ..... 133
Vizita ..... 135
Rjetë magjike ..... 137
Gota ..... 139
Mendime nate ..... 140
Lida-s ..... 141
Mallëngjim ..... 142
Dhëndri ..... 143
Duke u ngritur hën' e plotë ..... 144
Parabulla ..... 146
Legjendë ..... 148
Nga Vilhelm Majster-i .. 150

ART

Pikat e nektarit ..... 151
Shtegtari ..... 152
Amori si piktor (peisazhi) 159

Faqe

EPIGRAMATIKË

Shoqëri ..... 162
Ndalim ..... 163
Mënyrë jetese ..... 164
Kusht ..... 165
Gjëja më e mirë ..... 166
Vezë e freskët, vezë e mirë ..... 167
Pleqëria ..... 168
Për protestantin gjer tashi ..... 169

NGA POSTUMET

Bërtitja ..... 170
Dashuri dhe virtut .... 171
Dashuri pa dashur .... 172
Zonjushës N. N. ..... 173
Pas italishtes ..... 174
Kuitim ..... 175

LIRIKA

Paria (lutja e Paria-s) .. 176
Legjendë ..... 177
Falënderimi i Paria-s .. 181
Mars ..... 182
Prill ..... 183

ZOTI DHE BOTA

Proemion ..... 184
Qëndrim në ndryshim .. 185
Parabazë ..... 187

NGA GJUHË TË HUAJA

Skolion dashurie «neogrek: Kush ka të drejtë? 188
Balladë e lashtë skoceze 189

## JANE NE QARKULLIM

### Letërsi artistike

*Autorë të huaj*

| | | Lekë |
|---|---|---|
| A. Çehov | — Drama | 40 |
| Aristoteli | — Poetika | 25 |
| E. Pelin | — Lajthitje pranverore (Tregime) | 30 |
| R. Rolan | — Jeta e Bethovenit | 20 |
| Xh. Verga | — Familja e Malavolajve (Roman) | 50 |
| J. Efremov | — Mjegullnaja e Andromedës | 60 |
| Autorë të ndryshëm | — Poezi klasike kineze | 45 |
| R. Tagora | — Kopshtari (Lirika) | 30 |
| R. Berns | — Vjersha dhe ballada | 50 |
| S Esenin | — Lirika | 40 |
| I. Bunin | — Zotnia nga San-Francisko (Tregime) | 35 |
| E Triole | — Trëndafilë me kredi (Roman) | 50 |
| L. N. Tolstoi | — Lufta dhe Paqja vëll. III-IV (Roman) | 50 |
| Ç. Dikens | — David Koperfildi vëll. I-II (Roman) | 50 |
| J. Otshenashek | — Qytetari Brih vëll I-II (Roman) | 50 |
| G. V. Plehanov<br>K. Vorovksi A V<br>Llunaçarski M Gorki | — Estetika dhe letërsia vëll. I (Përmbledhje artikujsh) | 55 |
| G. E. Lesing | — Emilja Galloti (Tragjedi) | 25 |
| CAO Y | — Shtërgata (Dramë) | 25 |
| L. N. Tolstoi | — Ringjallja (Roman) | 70 |
| I S. Turgeniev | — Rudini (Roman) | 30 |
| Tomas Man | — Budenbrokët (Roman) | 75 |
| L. N. Tolstoi | — Ana Karenina vëll. II (Roman) | 55 |
| Gustav Flobert | — Zonja Bovari (Roman) | 50 |
| Sergej Antonov | — Në rrugë kalojnë maqinat (Tregime) | 40 |
| Hoze Soler Puig | — Bertilon 166 (Roman) | 2 |
| Mark Tven | — Vjedhja e elefantit të bardhë | 40 |
| Anatol Frans | — Perënditë kanë Etje (Roman) | 45 |
| Titus Popoviç | — Etja (Roman) | 70 |

Çmimi: Lek 40